



# RAPORTI VJETOR <sup>2009</sup>

MBI AKTIVITETET GJYQËSORE TË GJYQTARËVE TË EULEX-it



European Union  
Rule of Law Mission



# Përmbajtja

Parathënie nga Gjyqtarja Maria Giuliana Civinini, Kryetare e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it .....	03
<b>I. Lista e akronimeve .....</b>	<b>04</b>
<b>II. Përmbledhje ekzekutive .....</b>	<b>05</b>
<b>III. Hyrje .....</b>	<b>07</b>
1) Baza juridike për funksionet gjyqësore të gjyqtarëve të EULEX-it .....	08
2) Njësia e gjyqtarëve të EULEX-it – dërgimi i staftit nëpër gjykatat e Kosovës .....	09
<b>IV. Gjykimi i lëndëve penale dhe civile – studim i lëndëve dhe statistikë .....</b>	<b>10</b>
<b>1. Lëndët e trashëguara nga UNMIK-u .....</b>	<b>10</b>
a. Krimet e luftës kundër popullsisë civile, terrorizmi, vrasjet e shumëfishta të rënda .....	11
b. Trazirat e marsit 2004 .....	23
<b>2. Ushtrimi i autorizimeve të Kryetares së gjyqtarëve të EULEX-it sipas Ligjit mbi kompetencat – analizë e vendimeve dhe të dhëna statistikore .....</b>	<b>28</b>
a. Baza ligjore e autorizimeve të Kryetares së Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it .....	28
b. Kërkesat për marrjen e lëndëve penale dhe civile – statistikë dhe analizë .....	30
c. Përmbledhje të lëndëve penale të marra nga gjyqtarët e EULEX-it .....	32
d. Kërkesat për marrjen e lëndëve civile – statistikë dhe analizë më specifike .....	35
<b>3. Gjykimi i lëndëve penale gjatë ushtrimit të kompetencës primare / ekskluzive dhe sekondare / subsidiare të gjyqtarëve të EULEX-it .....</b>	<b>35</b>
<b>4. Gjykimi i lëndëve civile – çështjet kryesore dhe statistika .....</b>	<b>39</b>
<b>V. Kolegji për ankesa të AKP-së në Gjykatën Supreme të Kosovës .....</b>	<b>44</b>
<b>VI. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me AKM-në .....</b>	<b>45</b>
<b>VII. Përfundim: të arriturat dhe sfidat në të ardhmen .....</b>	<b>48</b>
<b>VIII. Statistikë .....</b>	<b>49</b>

# Parathënie nga Gjyqtarja Maria Giuliana Civinini

Kryetare e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it

Ka kaluar më shumë se një vit që kur gjyqtarët e EULEX-it filluan t'i ushtrojnë funksionet e tyre gjyqësore në gjykatat e Kosovës. Shpallja e Kapacitetit Fillestar Veprues (KFV) më 9 dhjetor 2008 shënoi edhe fillimin e funksioneve gjyqësore të gjyqtarëve të EULEX-it. Megjithatë, përgatitjet për fillimin e punës në gjyqësor kishin filluar më herët.



Gjyqtarët e parë evropianë u dërguan në Kosovë në prill 2008. Më 10 korrik 2008 u mbajt Asambleja e parë e gjyqtarëve të EULEX-it. Asambleja e gjyqtarëve është përgjegjëse për menaxhimin e punës së EULEX-it. Si punë të parë, Asambleja ka miratuar Udhëzimet për caktimin e lëndëve për gjyqtarët e EULEX-it në lëndët penale dhe civile në gjykatat e qarkut. Më 23 tetor 2008 seanca e dytë e Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it, me pjesëmarrjen e 17 gjyqtarëve, finalizuan Udhëzimet për caktimin e lëndëve për gjyqtarët e EULEX-it në lëndët penale në Gjykatën Supreme të Kosovës dhe Udhëzimet organizative për ekipet e gjyqtarëve të EULEX-it. Këto rregulla dhe udhëzime të përfunduara deri në asamblenë e parë dhe të dytë kanë vënë bazamentin për organizimin e funksioneve të ardhshme gjyqësore të gjyqtarëve të EULEX-it.

Deri në fillim të dhjetorit 2008, ishin përcaktuar aspekte të ndryshme të menaxhimit të punës së ekipeve të gjyqtarëve të EULEX-it, duke përfshirë caktimin e personave kontaktues administrativë për secilën gjykatë, përbërjen e trupave gjyqësore, identifikimin e lëndëve të pazgjidhura penale dhe civile që duhet të gjykohen nga gjyqtarët e EULEX-it, dhe organizimin e shqyrtimeve gjyqësore. Po ashtu janë përpiluar udhëzimet për ngritjen e një sistemi të menaxhimit të korrespondencës dhe të qarkullimit të dokumenteve për ekipet e EULEX-it në gjykatat e qarkut.

Aktualisht, janë gjithsej 31 gjyqtarë dhe 25 zyrtarë ligjorë të EULEX-it të vendosur së bashku me homologët e tyre vendorë në të gjitha gjykatat e qarkut dhe në Gjykatën Supreme të Kosovës. Gjyqtarët e EULEX-it dhe ata kosovarë punojnë përkrah njëri-tjetrit dhe i gjykojnë lëndët së bashku në kolegjet e përziera. Është arritur një shkallë e lartë e partneritetit me homologët tanë vendorë – Kryetarët e gjykatave, gjyqtarët dhe referentët e Gjykatës Supreme, të gjykatave të qarkut dhe të gjykatave komunale në Kosovë. Përveç kësaj, janë vendosur marrëdhënie edhe me Odën e Avokatëve të Kosovës përmes një marrëveshjeje teknike që përcakton bashkëpunimin dhe bashkërendimin. Vetëm përmes këtyre përpjekjeve të përbashkëta ne mund të arrijmë sukses në zgjidhjen e lëndëve të mbetura në gjykatat e Kosovës dhe në gjykimin e shpejtë të lëndëve të reja të cilat bien në përgjegjësinë e gjyqtarëve të EULEX-it, dhe është pikërisht vendosja në objektet e përbashkëta me gjyqtarët vendorë si dhe bashkëpunimi me ta që në të ardhmen mund të rezultojë me sukses të sistemit të drejtësisë në Kosovë.

Ky raport është përpilim i informatave mbi punën e gjyqtarëve të EULEX-it gjatë përmbushjes së funksioneve të tyre ekzekutive në gjykatat e Kosovës gjatë vitit 2009. Falënderimet e mia të posaçme shkojnë për Gergana Arabadjieva dhe Kathinka Hewit, të cilat kanë përpiluar informatat si dhe kanë përgatitur dhe kanë hartuar raportin.

## I. Lista e akronimeve

**EULEX** – Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë

**MUK** – Monitorimi, Udhëzimi dhe Këshillimi

**ZPSK** – Zyra e Prokurorisë Speciale të Kosovës

**AKM** – Agjencia Kosovare e Mirëbesimit

**DhPGjS** – Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me AKM-në

**AKP** – Agjencia Kosovare e Pronës

**KGjK** – Këshilli Gjyqësor i Kosovës

**KKBP** – Komisioni për Kërkesa Banesore Pronësore

**KKKP** – Komisioni Kosovar për Kërkesa Pronësore

**GjPNJ** – Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë

**KPK** – Kodi Penal i Kosovës

**KPPK** – Kodi i Procedurës Penale i Kosovës

**KPRSFJ** – Kodi Penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë

**LPK** – Ligji Penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës

**LPP** – Ligji mbi Procedurën Penale

**KEDNj** – Konventa Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut

**PK** – Policia e Kosovës

**GjS** – Gjykata Supreme

**GjQ** – Gjykata e Qarkut

**GjK** – Gjykata Komunale

## II. Përmbledhje ekzekutive

Ky raport është një përpilim i informatave për punën e gjyqtarëve të EULEX-it në përmbushjen e funksioneve të tyre ekzekutive në gjykatat e Kosovës gjatë vitit 2009, përkatësisht vitit të parë të operimit të këtij Misioni. Gjyqtarët e EULEX-it përfaqësojnë një pjesë përbërëse të Komponentit të Drejtësisë së Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX). Gjyqtarët e EULEX-it janë shtetas të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian ose të shteteve të tjera kontribuuese (Norvegjia, Zvicra, Turqia, Kroacia, ShBA-ja dhe Kanadaja) si dhe gjyqtarë aktivë në vendet e tyre.

Aktualisht, janë gjithsej 31 gjyqtarë dhe 25 zyrtarë ligjorë ndërkombëtarë të EULEX-it të vendosur së bashku me homologët e tyre vendorë nëpër të gjitha gjykatat e Kosovës. Përveç tyre, janë edhe këshilltarët ligjorë vendorë, asistentët administrativë dhe gjuhësorë si dhe përkthyesit për shqip/anglisht dhe për serbisht/anglisht. Ndihma e stafit vendor është e domosdoshme për ushtrimin efikas të funksioneve gjyqësore të gjyqtarëve të EULEX-it. Gjyqtarët e EULEX-it kryejnë detyrat e tyre nëpër tërë Kosovën. Ekipet e gjyqtarëve të EULEX-it janë të vendosura në të pesë Gjykatat e Qarkut, në Gjykatën Supreme dhe në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

Gjyqtarët e EULEX-it ushtrojnë funksionet e tyre gjyqësore në pajtim me Ligjin mbi kompetencat. Ligji mbi kompetencat u jep gjyqtarëve të EULEX-it kompetenca primare/ekskluzive dhe kompetenca sekondare/subidiare mbi një varg procedurash penale. Ky spektër i gjerë i veprave penale përfshin në mes tjerash terrorizmin; gjenocidin; krimet kundër njerëzimit; krimet e luftës; krimin e organizuar; nxitjen e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar a etnik; vrasjen dhe vrasjen e rëndë, krimet ekonomike. Këto krime nga më të rëndat qofshin edhe në formë të tentativës dhe në forma të ndryshme të bashkëveprimit në kryerjen e krimit janë në kuadër të autorizimeve për hetime dhe për ndjekje penale të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) dhe në këtë mënyrë bien nën kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it.

Përveç kësaj, gjyqtarët e EULEX-it ushtrojnë kompetencat e tyre edhe në lëndët civile. Sipas nenit 5.1 të Ligjit mbi kompetencat, gjyqtarë civilë të EULEX-it kanë të drejtën e përzgjedhjes dhe të marrjes së përgjegjësisë mbi lëndët civile në kuadër të kompetencave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me AKM-në, mbi lëndët që bien brenda kompetencave të çdo gjykate të Kosovës përkitazi me ankesat ndaj vendimeve të Komisionit kosovar për kërkesa pronësore, dhe mbi çdo lëndë civile të re apo të pazgjidhur pronësore.

duke përfshirë procedurën e përmbartimit që bie brenda kompetencave të cilësdo gjykatë në Kosovë sipas kushteve të përcaktuara me nenin 5.1 (c) të Ligjit mbi kompetencat.

Në mes të datës 18 dhjetor 2008 dhe 31 mars 2009, gjyqtarët e EULEX-it kanë pranuar 185 lëndë penale nga UNMIK-u, i cili i kishte përmbyllur aktivitetet gjyqësore. Këto lëndë komplekse penale përbënin procedura penale të procedurës paraprake, aktakuza, gjykime, ankesa, mjete të jashtëzakonshme juridike dhe rigjykime. Akuzat ishin nga më të ndryshmet duke filluar nga krime lufte kundër popullsisë civile dhe larje parash e deri tek krimi i organizuar dhe terrorizmi. Gjyqtarët e EULEX-it nga kjo trashëgimi e UNMIK-ut ndalën 120 lëndë. Pjesa tjetër e lëndëve penale, ku nuk kishte baza për caktimin e kompetencës primare

apo subsidiare të Gjyqtarëve të EULEX-it, kryesisht iu referuan për procedim të mëtejshëm sipas nevojës gjykatave kompetente kosovare ose iu dhanë prokurorëve të EULEX-it për shqyrtim të mëtejshëm.

Përpunimi i shkresave të lëndëve të trashëguara nga UNMIK-u është caktuar prioritet për gjyqtarët e EULEX-it që kur ata filluan me ushtrimin e autorizimeve të tyre gjyqësore. Paragrafi 1 i Pjesës IV të këtij raporti përqendrohet në dy kategori të rëndësishme të lëndëve të pranuar nga gjyqtarët e EULEX-it – dhe ato krime lufte kundër popullsisë civile, të kryera gjatë luftës në Kosovë në periudhën 1998-1999 si dhe krimet e kryera gjatë trazirave që ndodhën në Kosovë në mars të vitit 2004. Këto lëndë u kaluan në kompetencë të Gjyqtarëve të EULEX-it si në Gjykatën Supreme ashtu edhe në Gjykatat e Qarkut të Kosovës. Ky raport jep një përmbledhje të lëndëve të krimeve të luftës dhe të trazirave të marsit 2004, të cilat tashmë janë përfunduar nga gjyqtarët e EULEX-it.

Paragrafi 2 i Pjesës IV përshkruan kompetencën sekondare/subsidiare të gjyqtarëve të EULEX-it. Neni 3.5 i Ligjit mbi kompetencat interpreton “nevojën për të siguruar zbatimin e duhur të drejtësisë”. Sipas këtij neni, gjyqtarët e EULEX-it mund të ndërhyjnë “nëse është kërcënuar gjyqtari kosovar, apo dëshmitarët apo palët në procedurën që lidhet me rastin, dhe nëse një gjë e tillë shpie arsyeshëm në besimin se do të kishte keqpërdorim serioz të drejtësisë po qe se lënda mbetet në përgjegjësinë ekskluzive të gjyqtarëve kosovarë”. Sipas dispozitës së njëjtë të Ligjit mbi kompetencat, kushti i dytë për caktimin e gjyqtarëve të EULEX-it në procedurën penale është “po qe se është e arsyeshme të besohet se ka nevojë për aktivitetin e gjyqtarëve të EULEX-it, për shkak të natyrës veçanërisht komplekse të asaj lënde, me qëllim të shmangies së keqpërdorimit të drejtësisë.”

Paragrafi 2 po ashtu trajton kërkesat që EULEX-i të marrë lëndët penale, së bashku me statistikat dhe analizën për ato lëndë. Në periudhën kohore janar 2009 – janar 2010, është pranuar një numër total prej 89 kërkesash për marrjen e lëndëve civile dhe penale, prej të cilave 53 kërkesa lidheshin me lëndë penale, ndërsa 11 sosh me lëndë civile. Nga këto 53 kërkesa për marrjen e lëndëve penale, 38 janë pranuar, 10 janë refuzuar dhe 5 janë hedhur poshtë. Një numër i madh i lëndëve penale janë pranuar në Mitrovicë (nga 21 kërkesa, 19 ishin për lëndë penale dhe 17 prej tyre ishin miratuar). Ky numër i madh i kërkesave, kryesisht nga prokurorë të EULEX-it në Mitrovicë, shpjegohet me natyrën komplekse të gjendjes politike dhe asaj juridike në këtë rajon, dhe me procesin e vazhdueshëm për rikthimin e funksionimit efektiv të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës. Me qëllim të shmangies së zvarritjes së mëtejshme të procedurave penale, Prokurorët e EULEX-it kërkojnë të marrin përsipër këto lëndë penale dhe t’i caktojnë ato për gjyqtarët e EULEX-it. Përmbledhje të disa prej këtyre lëndëve penale të marra dhe të shqyrtuara nga gjyqtarët e EULEX-it janë të dhëna në Paragrafin 3 të këtij raporti.

Paragrafi 4 përshkruan rolin e gjyqtarëve të EULEX-it në lëndët civile dhe jep shembuj të shqyrtimit të lëndëve civile në Gjykatat Komunale dhe ato të Qarkut në Kosovë. Në vitin 2009, numri më i madh i lëndëve civile (21) është shqyrtuar në rajonin e Pejës. Prej këtyre lëndëve, njëra është shqyrtuar në nivelin e gjykatës së qarkut nga kolegji i përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar kosovar. 20 Lëndët e tjera janë shqyrtuar në nivelin e gjykatës komunale nga ana e një gjyqtari të EULEX-it. Deri në dhjetor 2009, katërmbëdhjetë lëndë janë mbyllur dhe aktgjykimet janë lëshuar. Të gjitha këto aktgjykime janë ankimuar nga palët dhe tash janë në pritje në nivelin e gjykatës së qarkut.

Pjesa V përqendrohet në kompetencat e Kolegjit për ankesa të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ndërsa Pjesa VI bën fjalë për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme

për çështjet që lidhen me AKM-në. Ky raport përshkruan bazën ligjore të mandatit të Kolegjit për Ankesa të AKP-së dhe të DhPGJS-së si dhe lëndët që bien nën kompetencat e Kolegjit për Ankesa të AKP-së dhe të DhPGJS-së.

Pjesa VII vlerëson të arriturat e gjertanishme si dhe sfidat që mbeten për të ardhmen. Lëndët e trashëguara nga UNMIK-ut tashmë janë përfunduar në nivelin e Gjykatës Supreme, ndërsa gjykatat e qarkut gjithashtu kanë bërë një përparim të ndjeshëm në përmbushjen e këtij synimi. Gjyqtarët e EULEX-it në rajonin e Mitrovicës kanë marrë përsipër dhe kanë përfunduar një sërë lëndësh komplekse penale, duke kontribuar kështu në përpjekjet për rikthimin e funksionimit efektiv të GjQ-së në Mitrovicë. Punë tjetër që është bërë është përkrahja për gjyqtarët kosovarë në trajtimin e rasteve të pazgjidhura të 22,000 “lëndëve të pezulluara”, të cilat përfshijnë kërkesa për dëmshpërblim nga KFOR-i, nga UNMIK-u dhe nga komunitet e vendit. Këto prioritete vazhdojnë të mbeten në agjendën e gjyqtarëve të EULEX-it për vitin 2010.

### III. Hyrje

Gjyqtarët e EULEX-it përfaqësojnë një pjesë përbërëse të Komponentit të Drejtësisë së Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (tani e tutje “EULEX”). EULEX-i është misioni më i madh civil i ndërmarë ndonjëherë nga Politika e Përbashkët për Siguri dhe Mbrojtje e BE-së (PBSM). Synimi kryesor është ofrimi i ndihmës dhe i mbështetjes në fushën e sundimit të ligjit për autoritetet e Kosovës, në mënyrë të veçantë sektorit të policisë, të gjyqësorit dhe të doganës. Ky mision nuk për qëllim të qeverisë me Kosovën apo ta sundojë atë. Është një mision teknik i cili monitoron, udhëzon dhe këshillon, duke mbajtur disa kompetenca të kufizuara ekzekutive. EULEX-i vepron në kuadër të kornizës së përgjithshme të Rezolutës 1244 të Kombeve të Bashkuara dhe ka një zinxhir të unifikuar komandues në Bruksel. Baza ligjore e tij është Veprimi i Përbashkët i datës 4 shkurt 2008<sup>1</sup>.

Ky raport mbulon aktivitetet e gjyqtarëve të EULEX-it gjatë zbatimit të mandatit të tyre ekzekutiv. Gjyqtarët e EULEX-it janë shtetas të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian ose të shteteve të tjera kontribuuese (Norvegjia, Zvicra, Turqia, Kroacia, ShBA-ja dhe Kanadaja), të cilët janë gjyqtarë aktivë në vendet e tyre të origjinës. Për shkak të natyrës specifike të funksioneve të tyre, krahas monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit (MUK) të homologëve të tyre vendorë, gjyqtarët e EULEX-it ushtrojnë edhe funksione ekzekutive, në përputhje me Ligjin mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve për gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it në Kosovë, Ligji Nr. 03/L-053 (më tej “Ligji mbi kompetencat”).

Ky raport është përgatitur nga stafi i zyrës së Kryetares së Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it me synim të ofrimit të një pasqyre të veçantë përkitazi me funksionet ekzekutive/gjyqësore të gjyqtarëve të EULEX-it nëpër gjykatat e Kosovës; dhe nuk përshin punët e gjyqtarëve të EULEX-it gjatë monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit. Periudha e mbuluar në raport fillon që nga shpallja e Kapacitetit Fillestar Veprues (KFV) të EULEX-it më 9 dhjetor 2008, që po ashtu shënonte edhe fillimin e ushtrimit të funksioneve ekzekutive të gjyqtarëve të EULEX-it në gjykatat e Kosovës.

1 VEPRIMI I PËRBASHKËT I KËSHILLIT 2008/124/CFSP, i datës 4 shkurt 2008, për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX KOSOVO; dhe VEPRIMI I PËRBASHKËT I KËSHILLIT 2009/445/CFSP, i datës 9 qershor 2009 duke ndryshuar Veprimin e Përbashkët 2008/124/CFSP për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë



# 1. Baza ligjore e funksioneve gjyqësore të gjyqtarëve të EULEX-it

Gjyqtarët e EULEX-it ushtrojnë funksione gjyqësore në Kosovë në përputhje me Ligjin mbi kompetencat. Ligji mbi kompetencat u jep gjyqtarëve të EULEX-it kompetenca primare/ekskluzive dhe sekondare/subsidiare lidhur me një varg procedurash penale.

Kompetenca primare/ekskluzive e gjyqtarëve të EULEX-it është e përcaktuar në Nenin 3.1 të Ligjit mbi kompetencat dhe pason kompetencat për ndjekje dhe hetime penale të Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSRK), të përcaktuara në Ligjin nr. 03/L-052 mbi Prokurorinë Speciale të Kosovës, të datës 13 mars 2008 (më tej "Ligji mbi PSRK-në"). Nenet 5 dhe 9 të Ligjit mbi PSRK-në radhisin krimet sipas Kodit Penal të Kosovës (KPK), Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ) dhe Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (LPK), të cilat hetohen dhe ndiqen penalisht nga ana e PSRK-së. Ky spektër i gjerë i veprave penale përfshin mes tjerash terrorizmin; gjenocidin; krimet kundër njerëzimit; krimet e luftës; krimin e organizuar; nxitjen e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar a etnik; vrasjen dhe vrasjen e rëndë, krimet ekonomike. Këto krime nga më të rëndat qofshin edhe në formë të tentativës dhe në forma të ndryshme të bashkëveprimit në kryerjen e krimit janë në kuadër të autorizimeve për hetime dhe për ndjekje penale të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) dhe në këtë mënyrë bien nën kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it.

Kompetenca subsidiare, e cila ushtrohet vetëm në ato raste kur krimi nuk është hetuar apo nuk është ndjekur penalisht nga PRSK-ja, përcaktohet në Nenet 3.3 dhe 3.4 të *Ligjit mbi kompetencat*. Siç thuhet në Nenin 3.3 të *Ligjit mbi kompetencat*, kompetenca subsidiare ushtrohet në rast të dyshimeve për zbatimin e duhur të drejtësisë, me kërkesë të prokurorit, të kryetarit të gjykatës kompetente apo të cilësdo palë të procedurës. Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, pastaj për çfarëdo arsye, kur të konsiderohet e nevojshme sigurimi i zbatimit të duhur të drejtësisë, mund të caktojë gjyqtarët e EULEX-it në procedurë. Kompetenca subsidiare po ashtu mund të ushtrohet sipas Nenit 4.1 të *Ligjit mbi kompetencat*, atëherë kur ka kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit kosovar. Në këtë rast, Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it do të ketë kompetencë që t'i caktojë gjyqtarët e EULEX-it në cilëndo fazë të procedurës përkatëse penale. Kërkesa për përjashtim, megjithatë, duhet të konstatojë se caktimi i një gjyqtari tjetër kosovar në procedurë nuk mënjanon rrethanat që vënë në dyshim paanësinë e gjyqtarit kosovar.

Përveç kësaj, gjyqtarët e EULEX-it ushtrojnë kompetencat e tyre edhe në lëndët civile. Sipas Nenit 5.1 të *Ligjit mbi kompetencat*, gjyqtarët civilë të EULEX-it kanë kompetenca që të përzgjedhin dhe të marrin përgjegjësinë për lëndët civile nën juridiksionin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (më tej "DhPGJS"), për lëndët që bien nën përgjegjësinë e çdo gjykate kosovare përkitazi me ankesat kundër vendimeve të Komisionit kosovar për kërkesa pronësore, dhe për çfarëdo lëndë të reja apo të pazgjdhura civile që kanë të bëjnë me pronën, duke përfshirë edhe procedurat e përmbarrimit që bien nën juridiksionin e të gjitha gjykatave në Kosovë, sipas kushteve të përcaktuara me Nenin 5.1 (c) të *Ligjit mbi kompetencat*.

Caktimi i lëndëve të gjyqtarëve të EULEX-it bëhet në përputhje me dispozitat e sipërpërmendura të *Ligjit mbi kompetencat* dhe me modalitetet e zhvilluara nga Asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it, siç përcaktohet me Nenet 3 deri në 5 të *Ligjit mbi kompetencat*. Udhëzimet për caktimin e lëndëve për gjyqtarët e EULEX-it në lëndët penale dhe civile në gjykatat e qarkut, janë përgatitur nga Asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it më 10 korrik 2008. Më 23 tetor 2008, Asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it ka



miratuar udhëzimet për caktimin e gjyqtarëve të EULEX-it në lëndët penale në Gjykatën Supreme të Kosovës. Duke marrë parasysh natyrën specifike të kompetencave të DhPGjS-së, më 2 mars 2009, Asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it njëzëri ka miratuar rregullat për themelimin e një Trupi Gjykues dhe të një Kolegji për Ankesa të DhPGjS-së, për caktimin e lëndëve dhe për rregulloren e re të punës. Sistemi i caktimit të lëndëve i zhvilluar nga Asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it mbështetet në parimet e transparencës, objektivitetit, fleksibilitetit, qëndrueshmërisë, dhe barazisë së barrës së punës së gjyqtarëve.

## 2. Njësia e Gjyqtarëve të EULEX-it

### Personeli

Përbërja e tanishme e Njesisë së Gjyqtarëve përfshin 31 gjyqtarë dhe 25 zyrtarë ligjorë të EULEX-it. Shefe e kësaj njësie është Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it.

### Shpërndarja e gjyqtarëve dhe zyrtarëve ligjorë të EULEX-it është si vijon:

- 5 gjyqtarë në Gjykatën Supreme (GjS), duke përfshirë edhe Kryetaren e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it;
- 2 gjyqtarë në Kolegjin për Ankesa të AKP-së;
- 8 (+ 3 pritjet të vijnë) gjyqtarë penalë në nivelin e Gjykatës së Qarkut (GjQ);
- 8 (+ 4 pritjet të vijnë) gjyqtarë civilë në nivelin e GjQ-së;
- 5 gjyqtarë të shkallës së parë për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DhPGjS), dhe
- 3 gjyqtarë për ankesa të AKP-së (DhPGjS).
- 16 zyrtarë ligjorë në nivelin e GjQ-së;
- 2 zyrtarë ligjorë në Gjykatën Supreme;
- 1 zyrtar ligjor për ankesa të AKP-së;
- 6 zyrtarë ligjorë në DhPGjS;
- Referenti kryesor i shkrimore për DhPGjS.

Në Gjykatën Supreme, në DhPGjS si dhe në të gjitha GjQ-të gjithashtu ka edhe këshilltarë ligjorë, asistentë administrativë dhe gjuhësorë si dhe përkthyes vendorë për shqip/anglisht dhe serbisht/anglisht. Ndihma e stafit vendor është e domosdoshme për ushtrimin efikas të funksioneve gjyqësore të gjyqtarëve të EULEX-it.

### Shpërndarja në Gjykatat e Qarkut të Kosovës

Gjyqtarët e EULEX-it kryejnë detyrat e tyre nëpër tërë Kosovën. Ekipet e gjyqtarëve të EULEX-it janë të vendosur në GjS dhe në DhPGjS të Kosovës. Po ashtu janë edhe 5 ekipe të gjyqtarëve të EULEX-it të dërguara në secilën Gjykatë të Qarkut (GjQ) të Kosovës. Aktualisht, përbërja e ekipeve të GjQ-ve është si më poshtë:

**GjQ në Prishtinë** – 3 gjyqtarë penalë dhe 1 gjyqtar civil të mbështetur nga 6 zyrtarë ligjorë dhe 3 këshilltarë ligjorë vendorë;



**GjQ në Gjilan** – 1 gjyqtar penal dhe 2 gjyqtarë civilë të mbështetur nga 3 zyrtarë ligjorë, 2 këshilltarë ligjorë dhe 1 asistent juridik vendor;

**GjQ në Pejë** – 1 gjyqtar penal dhe 1 gjyqtar civil të mbështetur nga 3 zyrtarë ligjorë dhe 2 këshilltarë ligjorë vendorë;

**GjQ në Prizren** – 1 gjyqtar penal dhe 2 gjyqtarë civilë të mbështetur nga 2 zyrtarë ligjorë, 1 këshilltar ligjor vendor dhe 1 asistent juridik vendor;

**GjQ në Mitrovicë** – 2 gjyqtarë penalë dhe 2 gjyqtarë civilë të mbështetur nga 2 zyrtarë ligjorë, 2 këshilltarë ligjorë vendorë.

## IV. Gjykimi i lëndëve penale – studim i lëndëve dhe statistikë

### 1. Lëndët e trashëguara nga UNMIK-u

Kalimi i lëndëve penale me të cilat janë marrë gjyqtarët ndërkombëtarë nga Departamenti i Drejtësisë së UNMIK-ut tek Gjyqtarët e EULEX-it ka filluar më 18 dhjetor 2008 dhe ka vazhduar deri më 31 mars 2009. Gjyqtarët e EULEX-it kanë pranuar 185 lëndë penale. Këto lëndë komplekse penale kanë përfshirë procedura penale gjatë hetimeve fillestare dhe gjatë procedurës paraprake, aktakuza, gjykime, ankesa, mjete të jashtëzakonshme juridike dhe rigjykime.

Akuzat radhiteshin nga krime lufte kundër popullsisë civile dhe larje parash e deri te krim i organizuar dhe kryerje e terrorizmit. Gjyqtarët e EULEX-it kanë ndalur për vete 120 lëndë nga kjo trashëgimi e UNMIK-ut.

Pjesa tjetër e lëndëve penale, në të cilat nuk kishte arsye për vendosjen e kompetencës primare apo shtesë të Gjyqtarëve të EULEX-it, u janë referuar kryesisht gjykatave kompetente të Kosovës për procedura të tjera të mëtejshme sipas nevojës, apo u janë përcjellë Prokurorëve të EULEX-it që t'i marrin parasysh.

Gjyqtarët e EULEX-it në Gjykatën Supreme kanë ndalur për vete 20 lëndë, 51 të tjera u janë referuar kompetencave të gjyqtarëve të EULEX-it në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës, 1 lëndë për gjyqtarët e EULEX-it në Gjykatën Komunale të Prishtinës.

Gjyqtarët e EULEX-it në Gjykatën e Qarkut të Pejës kanë pranuar 19 lëndë, 10 u janë referuar gjyqtarëve të EULEX-it në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës, 5 lëndë Gjykatës së Qarkut të Gjilanit, dhe 2 lëndë Gjykatës Komunale të Gjilanit. Gjyqtarët e EULEX-it në Gjykatën e Qarkut të Prizrenit kanë pranuar 12 lëndë penale.

Përpunimi i shkresave të lëndëve të trashëguara nga UNMIK-u është përcaktuar si prioritet për Gjyqtarët e EULEX-it që nga fillimi i ushtrimit të kompetencave të tyre gjyqësore.

Ky kapitull i raportit përqendrohet në dy kategori kryesore të lëndëve të pranuar nga Gjyqtarët e EULEX-it dhe atë krime të luftës kundër popullsisë civile të kryera gjatë luftës në Kosovë në periudhën 1998-1999, dhe krimet e kryera gjatë trazirave të marsit 2004 në Kosovë.



Këto lëndë janë kaluar në kompetencë të Gjyqtarëve të EULEX-it në Kosovë si në Gjykatën Supreme ashtu edhe në Gjykatat e Qarkut. Ky raport ofron një përmbledhje të krimeve të luftës dhe të trazirave të marsit të cilat tashmë janë përfunduar nga gjyqtarët e EULEX-it. Lëndët në vazhdim është konstatuar të kenë qenë interesante si nga pikëpamja faktike ashtu edhe nga perspektiva procedurale. Këto lëndë përfshijnë vepra të rënda penale siç janë arrestim dhe mbajtje e paligjshme në paraburgim e civilëve (*Selim Krasniqi et alia*) si dhe shkatërrim i jashtëzakonshëm dhe vjedhje e pronës, frikësim dhe rrezikim i jetës përmes përdorimit të eksplozivit dhe të armëve të zjarrit (*Miroslav Vuckovic*). Gjykimi i këtyre krimeve serioze ka kërkuar shqyrtimin gjithëpërfshirës të koncepteve të zbatueshëm të së drejtës ndërkombëtare humanitare, të ligjit penal dhe të procedurës penale. Gjykata ka shqyrtuar mes tjerash edhe aspektin e përkohshëm si dhe atë gjeografik të “konfliktit të armatosur” sipas ligjit mbi të drejtën ndërkombëtare humanitare, nocionin e “dëshmitarit bashkëpunues” dhe të “gjykimit të aktgjykimit” sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK). Në mesin e lëndëve të përmbledhura në këtë raport është edhe një lëndë (*Gëzim Ferati*) në të cilën për herë të parë është shpallur aktgjykimi në mënyrë publike gjatë seancës gjyqësore (kjo praktikë në Gjykatën Supreme është futur në përdorim nga gjyqtarët e EULEX-it). Një tjetër lëndë penale e përzgjedhur për këtë raport (*Gani Haziraj*) është gjykuar nga gjyqtarët e EULEX-it si në shkallën e parë ashtu edhe në shkallën e dytë.

## **a) Krime të luftës kundër popullsisë civile, Terrorizëm, Vrasje e rëndë e shumëfishtë**

Në janar 2009, gjatë periudhës së kalimit të lëndëve, gjyqtarët ndërkombëtarë të UNMIK-it dorëzuan tek gjyqtarët e EULEX-it 3 lëndë penale që përfshinin krime të luftës të cilat ishin në pritje të ankesës ndaj aktgjykimit të shkallës së parë para Gjykatës Supreme të Kosovës. Natyrisht, të tri lëndët ishin përzgjedhur nën kompetencë të Gjyqtarëve të EULEX-it në Gjykatën Supreme pasi që kjo vepër penale bie nën kompetencën ekskluzive të tyre.

### ***Selim Krasniqi et alia***

Lënda penale kundër Selim Krasniqit ishte kryer më 10 prill 2009: ankesat e paraqitura në dobi të të pandehurve janë pranuar pjesërisht, dhe dënimi i tyre është zvogëluar. Lënda bënte fjalë për pohime lidhur me një qendër të jashtëligjshme paraburgimi të udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) në komunën e Rahovecit. Mes datave 1 maj 1998 dhe 31 gusht 1998, Selim Krasniqi, në bashkëpunim me të tjerë, dhe sipas një plani të përbashkët kriminal për mbajtje të paligjshme të civilëve shqiptarë kosovarë, ka marrë pjesë në arrestimin e jashtëligjshëm dhe paraburgimin e qytetarëve shqiptarë kosovarë të dyshuar për bashkëpunim me serbët dhe ka mbajtur ata qytetarë në një vend të ndodhur në fshatin Drenovc, ku ishin paraburgosur në kushte jonjerëzore pa procedurë të duhur, dhe ishin rrahur, duke u shkaktuar atyre vuajtje të mëdha dhe dëme në shëndetin e tyre. Në mesin e atyre civilëve, 12 individë – që ishin arrestuar dhe paraburgosur ilegalisht dhe rrahur- u identifikuan në aktgjykim.

Gjykata e Qarkut në Prizren, në kolegjin prej tre Gjyqtarëve ndërkombëtarë të UNMIK-ut, në aktgjykimin e lëshuar më 10 gusht 2006, shpalli Selim Krasniqin dhe dy të pandehurit tjerë fajtor për akuzat e lartpërmendura që u cilësuan si Krime të luftës kundër popullsisë civile. Të tre të pandehurit morën shtatë (7) vjet burgim.

Tre të pandehurit paraqitën ankesë kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën Supreme. Më 10 prill 2009, kolegji



për ankesë i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë prej tre Gjyqtarëve të EULEX-it dhe dy Gjyqtarëve Kosovarë, lëshoi aktgjykimin mbi këto ankesa. Më poshtë është njëra nga çështjet kryesore të ngritura në Ankesë dhe përfundimet e arritura nga Gjykata Supreme përkitazi me zbatimin e dispozitave të së drejtës ndërkombëtare humanitare në këtë lëndë.

**Ankesa** theksonte se për të pasur shkelje të së drejtës ndërkombëtare humanitare, patjetër duhet të kishte konflikt të armatosur. Kjo ankesë argumentonte aspekti i përkohshëm dhe ai gjeografik i “konfliktit të armatosur” nuk shkonte përtej kohës dhe vendndodhjes së saktë të këtyre armiqësive.

Gjykata Supreme i referohej vendimit të Odës për Ankesa të GjPNJ-së në lëndën *prokurori kundër Dusco Tadic* ku GjPNJ-ja konstaton se “defnicioni i “konfliktit të armatosur” ndryshon varësisht prej asaj se a janë armiqësitë ndërkombëtare apo të brendshme por, në kundërshtim me përmbajtjen e Ankuesit, shtrirja kohore dhe gjeografike e konflikteve të armatosura të brendshme si dhe ndërkombëtare kalon përtej kohës dhe vendit të saktë të armiqësive. Sa i përket referimit kohor ndaj konfliktit të armatosur, secila nga katër Konventat e Gjenevës përmban gjuhë që aludon se zbatimi i tyre mund të zgjerohet përtej ndërprerjes së luftimit. Për shembull, të dyja Konventat I dhe III zbatohen derisa personat e mbrojtur që kanë rënë në duar të armikut janë liruar dhe riatdhesuar ...”<sup>2</sup>

Gjykata Supreme më pastaj citon mendimin e Odës së Ankesave të GjPNJ-së në përkrahje të konceptit të kornizës së gjerë referuese gjeografike dhe kohore për konfliktet e armatosura e cila “pasqyrohet në faktin se përfituesit e nenit 3 të përbashkët të Konventave të Gjenevës janë ato që nuk luajnë rol aktiv (ose nuk kanë më ndonjë rol aktiv) në këto armiqësi. Kjo tregon se rregullat që i përmban neni 3 po ashtu zbatohen edhe jashtë kontekstit të ngushtë gjeografik të arenës faktike të operacioneve luftarake.”<sup>3</sup> Gjykata Supreme konstatoi se aspekti i përkohshëm i rregullave në fuqi qartazi shkonte përtej armiqësive ekzistuese. “Lidhja që kërkohet është raporti në mes të konfliktit dhe të privimit nga liria, dhe jo fakti se privimi ka ndodhur në mes të betejës.”<sup>4</sup>

Kolegji për ankesa pranoi pjesërisht ankesën e paraqitur në dobi të të pandehurit Selim Krasniqi, dhe zvogëloi dënimin e tij në gjashtë (6) vjet burgim. Përkitazi me dy të pandehurit tjerë, me pranimin e pjesëshëm të ankesave të paraqitura në dobi të tyre, kolegji ndryshoi aktgjykimin e shkallës së parë sa i përket kornizës kohore kur ishte kryer vepra penale si dhe sa i përket dënimit, që ishte zvogëluar në gjashtë (6) vjet burgim për të dy të pandehurit. Aktgjykimi i shkallës së parë u vërtetua në pjesën tjetër. Ky aktgjykim i Gjykatës Supreme ishte i formës së prerë dhe kundër tij nuk mund të paraqitej ankesë. I pandehuri, për këtë arsye, përmes avokatit të tij mbrojtës parashtrroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, e cila është në pritje në Gjykatën Supreme.

## **Idriz Gashi**

Pretendimet kundër Idriz Gashit përfshijnë se më 12 gusht 1998 ai vrau një qytetare Shqiptare Kosovare pasi ajo ishte ndaluar te një pikë kontrolli të UÇK-së në Fshatin Baran, sepse i pandehuri kishte supozuar

2 *Shih GjNPJ, Prokurori kundër Dusco Tadic, vendimi mbi ankesën bashkëbiseduese mbi kompetencën e datës 2 tetor 1995, paragrafi 67*

3 *Shih GjNPJ, Prokurori kundër Dusco Tadic, vendimi mbi ankesën bashkëbiseduese mbi kompetencën e datës 2 tetor 1995, paragrafi 69*

4 *Shih Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Selim Krasniqi et alia, 10 prill 2009*



se ajo ishte bashkëpunëtore e Serbisë. Trupi i saj u identifikua tek në maj 2007. Trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut në Pejë, i përbërë prej dy Gjyqtarëve të UNMIK-ut dhe një Gjyqtari vendor, shpalli Idriz Gashin fajtor për krime të luftës kundër popullsisë civile dhe i shqiptoi atij dënimin prej 15 vjet burgim.

I pandehuri parashtroi ankesë kundër këtij aktgjykimi para Gjykatës Supreme. Kolegji i Gjykatës Supreme i përbërë nga dy Gjyqtarë të EULEX-it dhe tre Gjyqtarë vendorë të Gjykatës Supreme shpallën vendimin e tyre mbi ankesën më 2 qershor 2009, duke pranuar pjesërisht ankesën e të pandehurit dhe duke kthyer lëndën në Gjykatën e Qarkut në Pejë për rigjykim.

Më poshtë është një pasqyrë e argumenteve të Ankesës dhe arsytimi i GjS-së:

**Ankesa** argumenton në mes tjerash se aktgjykimi i shkallës së parë ishte bazuar në dëshmi të dhëna nga një dëshmitar i cili fillimisht ishte marrë në pyetje nga Prokurori publik si i dyshuar dhe kundër të cilit ekzistonte një aktvendim mbi fillimin e hetimeve. Prandaj kjo dëshmi duhej të konsiderohej si e papranueshme.

**GjS**-ja konstatoi se edhe pse ishin filluar hetimet kundër dëshmitarit i cili ishte intervistuar dhe marrë në pyetje si i dyshuar, afati kohor gjashtëmujor i përcaktuar nga KPPK-ja për përfundimin e hetimeve kishte kaluar. Megjithatë, pas ekzaminimit të procedurës të caktuar me anë të KPPK-së për kohëzgjatjen dhe ndërprerjen e hetimeve GjS-ja gjen se "supozimi se një hetim ndërpritet absolutisht pas kalimit të afatit 6 mujor (siç është paraqitur nga Prokurori dhe pranuar nga Gjykata e shkallës së parë) është pa bazë ligjore."<sup>5</sup> Përkundrazi, është "e sigurt se skadimi i afatit 6 mujor nuk paraqet ndërprerjen e hetimeve ... lënda mbetet e hapur dhe Prokurori publik mund të paraqesë një aktakuzë në çdo kohë (me të vetmin kufizim që është parashkrimi)."<sup>6</sup> **GjS**-ja prandaj përfundoi se gjykata e shkallës së parë "ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale kur deklaroi se 'nuk kishte vazhdim të hetimeve'. **GjS**-ja po ashtu vërtetoi se ky dëshmitar ende e kishte statusin e të dyshuarit "si bashkëkryerës i mundshëm" dhe prandaj ai nuk është dashur të jepte dëshmi si një "dëshmitar i zakonshëm" por është dashur të "dëgjohet sipas formaliteteve të përcaktuara për dëshmitarët bashkëpunues".<sup>7</sup> Lidhur me "përdorimin praktik" të dëshmisë/deklaratës së këtij dëshmitari **GjS**-ja i referohet "parimit të aktgjykimit" nën nenin 157, par. 4 të KPPK-së që thotë se "gjykata nuk e shpall personin fajtor vetëm mbi bazën e dëshmisë së dhënë nga dëshmitari bashkëpunues".

**GjS**-ja përfundon se "Gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të rregullave të procedurës duke pranuar dëshminë e të dyshuarit pa formalitetin e përcaktuar për dëshmitarin bashkëpunues dhe duke lënë anash gjykimin e aktgjykimit" të përcaktuar me KPPK. GjS-ja konstatoi se si pasojë e kësaj ishte vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike." **GjS**-ja lëshoi një Aktvendim mbi anulimin e aktgjykimit të GjQ-së në Pejë dhe ktheu lëndën prapa për rigjykim në këtë GjQ. Përmbledhja e procedurës së rigjykimit në Gjykatën e qarkut në Pejë është dhënë më poshtë në këtë raport.

## **Florim Ejupi**

Më 6 qershor 2008, trupi gjykues në GjQ në Prishtinë i përbërë nga tre Gjyqtarë të UNMIK-ut shpalli fajtor Florim Ejupin për veprat penale të vrasjes së rëndë, vrasjes së rëndë në tentativë, terrorizëm, dhe shkaktim të rrezikut të përgjithshëm, diskriminim racor dhe posedim të paligjshëm të substancave shpërthyes dhe

5 *Shih* Aktgjykimi i Gjykatës Supreme , *Idriz Gashi* , 2 qershor 2009

6 fusnota. 5

7 fusnota. 5



e dënoi atë me dyzetë (40) vjet burgim.

Gjykata e shkallës së parë konstatoi se Florim Ejupi ishte përgjegjës në bashkëkryerje me persona tjerë të panjohur për vendosjen dhe shpërthimin e një mjeti shpërthyes të poseduar ilegalisht më 16 shkurt 2001 në afërsi të Fshatit Livadicë, Komuna Podujevë. Eksplozivi ishte vendosur në një kanal përgjatë rrugës së një kolone me autobusë që bartnin udhëtarë të etnisë Serbe nga Nishi i Serbisë për në Graçanicë në Kosovë. Rreth orës 11:15 paradite autobusi i parë i kolonës që bartte 57 udhëtarë u godit nga një shpërthim masiv që ngriti autobusin nga toka, shkatërroi pjesën e parme të tij dhe vrau në vend shoferin dhe udhëtarët e ulur në atë pjesë. Udhëtarët tjerë u lënduan rëndë, disa prej tyre vdiqën më vonë, gjersa u jepej ndihma mjekësore. Ky akt i dhunës krijoi një ndjenjë të pasigurisë personale tek grupi i qytetarëve të etnisë Serbe, rrezikoi jetën dhe trupin e njerëzve në një vend ku një numër i madh i njerëzve ishin mbledhur dhe rezultoi me vdekjen e 11 personave dhe lëndimin e rëndë të 10 personave. Në bazë të etnisë së tyre serbe, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të palëve të dëmtuara të njohura nga bashkësia ndërkombëtare ishin shkelur.

I pandehuri Florim Ejupi paraqiti ankesë përmes avokatit të tij mbrojtës kundër aktgjykimit. Shkresat e lëndës ishin dorëzuar te Gjyqtarët e EULEX-it nga UNMIK-u më 20 janar 2009 dhe me vendim të Kryetares së Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it kjo lëndë është përzgjedhur për Gjyqtarët e EULX-it më 21 janar 2009.

Kolegji pesë-gjyqtarësh i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga tre Gjyqtarë të EULEX-it dhe dy Gjyqtarë të Gjykatës Supreme mbajti një seancë për të dëgjuar ankesën dhe argumentet e Zyrës së Prokurorit të Shtetit/Zyrës së Prokurorit Publik më 10 mars 2009. Pas këshillimit të mbajtur më 10 dhe 12 mars 2009, Gjykata Supreme pranoi ankesën e të pandehurit, ndryshoi aktgjykimin e shkallës së parë, dhe liroi Florim Ejupin nga të gjitha akuzat për shkak të pamjaftueshmërisë së dëshmimeve të administruara gjatë procedurës penale. Më saktësisht, kolegji konstatoi se gjurmët e ADN-së të gjetura në një bisht cigareje që lidh të pandehurin me vendin e krimit, për shkak të trajtimit jo të duhur dhe mungesës së informatave rreth kohës kur është vendosur ai bisht cigareje në vendngjarje, janë të pamjaftueshme për të mbështetur fajësinë e Ejupit. Përveç kësaj, kolegji po ashtu konstatoi se dëshmia e dëshmitarit Alfa nuk është e besueshme; prandaj dënimi i Ejupit mbeti pa asnjë mbështetje të dokumentuar.

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) paraqiti mjet të jashtëzakonshëm juridik brenda afatit ligjor, një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, në dëm të të akuzuarit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të kodit të procedurës, për shkak të përjashtimit të pohuar të kryetarit të kolegjit të Gjykatës Supreme, interpretimit të gabuar të statusit të dëshmitarit Alfa; dhe vlerësimit të dëshmisë vërtetuese të ADN-së.

Kolegji i Gjykatës Supreme, Kosovës i përbërë nga një Gjyqtar i EULEX-it si kryetar i kolegjit dhe katër Gjyqtarë të Gjykatës Supreme njëri prej tyre si Gjyqtar raportues dhe tjerët si anëtarë të kolegjit më 10 nëntor 2009, refuzoi kërkesën e PSRK-së si të pabazuar.

## **Miroslav Vucković**

Lënda penale kundër të pandehurit Serb kosovar Miroslav Vucković përfshin pretendimet për shkatërrime



të shkallës së lartë dhe vjedhjes së pronës së Shqiptarëve Kosovarë, frikësim, dhe rrezikim të jetës duke përdorur mjete shpërthyes dhe armë zjarri në Fshatin Gushavc prej marsit deri në maj 1999. Kolegji i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, i përbërë nga dy Gjyqtarë të UNMIK-ut dhe një Gjyqtar vendor, në aktgjykimin e datës 25 tetor 2002, shpalli Miroslav Vucković-in fajtor për krime të luftës kundër popullatës civile dhe e dënoi atë me 12 vjet burgim. Duke vendosur mbi ankesat e paraqitura nga Avokatët mbrojtës të të pandehurit, Gjykata Supreme e Kosovës në një Aktvendim, të datës 15 korrik 2004, anuloi aktgjykimin e shkallës së parë dhe ktheu lëndën prapa në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim. Kolegji i rigjykimit, i përbërë tani nga tre Gjyqtarë të UNMIK-ut, më 23 maj 2008, përsëri dënoi Miroslav Vucković-in për krime të luftës me një dënim unik prej 8 vjetësh burgim; përveç kësaj Vucković ishte liruar prej tri nën-pikave të akuzave për krimeve të luftës. Në të njëjtën kohë ishte lëshuar një urdhër paraburgimi kundër të akuzuarit i cili kishte ikur nga Kosova gjatë shqyrtimit gjyqësor. I akuzuari dhe avokatët e tij mbrojtës u ankuan ndaj këtij Aktgjykimi dhe urdhrit për paraburgim.

Më 7 tetor 2009, Gjykata Supreme e Kosovës në kolegjin e përbërë nga pesë Gjyqtarë të EULEX-it, ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, të datës 23 maj 2008, dhe liroi të akuzuarin nga të gjitha akuzat. Vendimi i Gjykatës Supreme që pranon ankesat dhe liron të akuzuarin është i bazuar në arsyet e përmbledhura shkurtimisht në vijim:

Procedura penale kundër të akuzuarit filloi më 1999. Gjatë viteve në vijim aktgjykimi i parë i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë ishte prishur nga ana e Gjykatës Supreme dhe lënda ishte kthyer për rigjykim. E njëjta gjë ndodhi edhe me aktgjykimin e dytë të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë. Gjykata Supreme me vendimin e lëshuar në korrik 2004 përsëri prishi aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë dhe ktheu lëndën për një rigjykim tjetër. Në atë vendim Gjykata Supreme i dha Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë udhëzime të qarta sa i përket shqyrtimit të hollësishëm me të cilin do të vlerësoheshin dëshmitë gjatë rigjykimit të dytë për shkak të rrethanave të veçanta të kësaj lënde. Rigjykimi i dytë – që ishte gjykimi i tretë në shkallë të parë – përfundoi me aktgjykimin e tanishëm të ankimuar, të datës 23 maj 2008.

Kolegji për ankesa i Gjykatës Supreme në vendimin e tij të datës 7 tetor 2009 konstatoi se Gjykata e shkallës së parë kishte dështuar t'i përmbahet udhëzimeve të dhëna nga Gjykata Supreme në vendimin paraprak (korrik 2004). Kushtet për një vlerësim të duhur dhe të saktë të dëshmitë, në veçanti të deklaratave të dëshmitarëve, të cilat në një shkallë të madhe ishin të prekura nga një numër i madh kundërthëniesh, nuk ishin plotësuar. Përveç kësaj Gjykata e shkallës së parë nuk arriti të vlerësojë si duhet alibinë e ngritur nga i akuzuari i cili pohoi se ai nuk kishte mundësi ti kryente ato krime për shkak të gjendjes së tij fizike. Gjykata e shkallës së parë nuk e pranoi këtë alibi pa një vlerësim të duhur të dy ekspertizave mjekësore dhe deklaratave të një numri të madh të dëshmitarëve të cilët kishin konfirmuar deklaratën e të akuzuarit.

Si pasojë Gjykata Supreme konstatoi se Gjykata e shkallës së parë prapë kishte dështuar në vërtetimin e saktë të fakteve. Në frymën e rrethanave të caktuara të kësaj lënde – një rigjykim tjetër do të ishte gjykimi i katërt para gjykatës së shkallës së parë – dhe në frymën e nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj)<sup>8</sup>, që i jep të drejtën secilit të pandehur për gjykim brenda një kohe të arsyeshme, Gjykata Supreme vendosi të mos urdhërojë një rigjykim tjetër, por të ndryshojë aktgjykimin e ankimuar dhe të shfajësojë të akuzuarin duke ku bazuar në faktin gjatë periudhës dhjetë vjeçare nuk ishte e mundur të vërtetoheshin akuzat kundër tij dhe prandaj zbatoi parimin *in dubio pro reo*.

8 Zyrtarisht e njohur si Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore



### ***Latif Gashi et alia (Grupi i Llapit)***

Aktgjykimi në lëndën penale kundër Latif Gashi u shpall më 2 tetor 2009 nga trupi gjykues i GjQ në Prishtinë i përbërë nga dy Gjyqtarë të EULEX-it dhe një Gjyqtari Kosovar. Tre të pandehurit u shpallën fajtor për vepër penale të krimeve të luftës kundër popullatës civile dhe u dënuan me 6 vjet; dhe përkatësisht 4 dhe 3 vjet burgim.

Rëndësia e kësaj lënde të krimeve të luftës ishte rritur edhe më shumë nga fakti se të tre të pandehurit mbanin pozita në administratën e Kosovës - Latif Gashi ishte këshilltar ligjor në Ministrinë e Ambientit, i pandehuri i dytë ishte i punësuar si Kryeshef Ekzekutiv i Kontrollit të Kredive në Post Telekomini e Kosovës (PTK), dhe i pandehuri i tretë ishte Deputet i Kuvendit të Kosovës.

### **Vendimi i Shkallës së Parë:**

Kjo lëndë ishte hetuar nga viti 2001 deri më 2002. Aktakuza fillestare ishte paraqitur më 19 nëntor 2002, dhe ishte ndryshuar dy herë. Versioni final i aktakuzës ngarkon të akuzuarin me veprën penale krime të luftës kundër popullatës civile, në shkelje të nenit 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, lidhur me nenet 22, 24, 26, dhe 30 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë –ligji në fuqi në procedurë sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/24, të ndryshuar me Rregulloren 2000/59, dhe në shkelje të dispozitës së Protokollit Shtesë II të Konventave të Gjenevës të datës 12 gusht 1949.

Aktakuza përmbante 14 pika të ndryshme për krime të luftës, duke përfshirë: paraburgim dhe arrestim të paligjshëm, rrahje, torturë, vrasje të pretenduara të kryera kundër qytetarëve Shqiptarë- Kosovarë dhe një qytetari Serb Kosovar që kishin ndodhur në mes të muajve gusht 1998 deri në mes të qershorit 1999 në qendra të ndryshme paraburgimi të përdorura nga ana e komandës së UÇK-së të zonës së Llapit për mbajtjen e qytetarëve të paraburgosur.

Aktgjykimi i shkallës së parë, i lëshuar nga GjQ në Prishtinë më 16 korrik 2003, shfajësoi të gjithë të akuzuarit nga disa nga akuzat. Megjithatë, tre të akuzuarit u dënuan për pikat/pjesën e mbetur të akuzave dhe u dënuan me 10, 13 dhe 17 vjet burgim.

### **Vendimi i Gjykatës Supreme**

Avokatët mbrojtës e të tre të akuzuarve paraqitën ankesa kundër të gjitha pikave të aktakuzës për të cilat klientët e tyre ishin shpallur fajtorë, kurse Prokurori nuk paraqiti ankesë ndaj asnjërit shfajësim. Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës, në vendimin e saj nuk mundi të ndryshoj asnjërën pikë të akuzës të cilat ishin vendosur me shfajësim me vendimin e shkallës së parë (parimi i *reformation in peius*) i cili është bërë *res judicata*.

Vendimi i Gjykatës Supreme nuk kundërshtoi asnjërin nga elementet e përgjithshme që kërkohen me të drejtën humanitare ndërkombëtare dhe ligjin vendor për krime të luftës (p.sh. statusi i konfliktit të armatosur; natyra e konfliktit; nexus).

Gjykata Supreme, me vendimin e saj të datës 21 korrik 2005, zvogëloi edhe më shumë shtrirjen e aktakuzës 'duke anuluar në tërësi' katër pikat (të gjitha të lidhura me akuzën e paraburgimit dhe arrestimit të paligjshëm), dhe duke shfajësuar të akuzuarit për vrasje të civilëve sepse pretendimet faktike nuk ishin dëshmuar 'përtej dyshimit të arsyeshëm'.

Gjykata Supreme përkrahu përfundimin e kolegjit të shkallës së parë dhe vërtetoi përgjegjësinë e të akuzuarit për krimin e torturës së qytetarëve Shqiptarë Kosovarë në qendrën e paraburgimit të Llapashticës, por ktheu këtë pikë të akuzës për rigjykim në pjesën që ka të bëjë me dënimin që trupi gjykues i rigjyimit të përcaktojë kohëzgjatjen adekuate të burgimit. Tri pika tjera të aktakuzës po ashtu ishin kthyer në Gjykatën e shkallës së parë.

## **Pikat e mbetura të aktakuzës para Gjykatës së Qarkut në Prishtinë**

Më 7 korrik 2009, rigjykimi kundër tre të akuzuarve filloi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë para kolegjit të përbërë nga dy Gjyqtarë të EULEX-it dhe një Gjyqtari Kosovar. Më 8 korrik 2009, kolegji lëshoi një vendim që qartëson pikat e mbetura të aktakuzës dhe pikat e mbetura i janë ish-in lexuar palëve. Asnjë vërejtje nuk ishte bërë nga ana e tyre.

Pikat e mbetura ishin *inter alia*:

### **PIKA 5**

*Prej tetorit 1998 deri në fund të prillit 1999, tre të pandehurit, duke vepruar në bashkëpunim me individë tjerë të panjohur dhe sipas ndërmarrjes së përbashkët penale, urdhëruan dhe morën pjesë në krijimin dhe kryerjen e trajtimit jonjerëzor të civilëve Shqiptarëve të Kosovës të mbajtur në qendrën e paraburgimit në Llapashticë, duke i mbajtur ata qytetarë të paraburgosur në kushte jonjerëzore, duke i privuar ata nga higjiena adekuate, ushqimi dhe uji, dhe trajtimi i nevojshëm mjekësor. Trajtimi jonjerëzor i civilëve të paraburgosur shkaktoi vuajtje të pamasë ose ishte shkelje e integritetit trupor dhe shëndetit të atyre të paraburgosurve dhe kjo përbën zbatim të masave të frikësimit dhe terrorit.*

### **PIKA 8**

*Nga tetori i vitit 1998 deri në prill të 1999, tre të akuzuarit duke vepruar në bashkëpunim me persona të tjerë të paidentifikuar dhe sipas ndërmarrjes së përbashkët penale, kanë marrë pjesë dhe kanë urdhëruar rrahjen dhe torturimin e civilëve shqiptarë të Kosovës të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Llapashticë, me tentativë që t'i detyrojnë këta të paraburgosur t'i pranojnë veprat e jo lojalitetit ndaj UÇK-së.*

*Duke urdhëruar dhe duke marrë pjesë në rrahjen dhe torturimin e civilëve shqiptarë të Kosovës [ilegalisht] të paraburgosur në qendrat e paraburgimit në Llapashticë, Majac dhe Potok, tre të pandehurit kanë përgjegjësi personale dhe superiore për krime të luftës, trajtim çnjerëzor, vuajtje e pamasë ose shkelje e integritetit trupor apo të shëndetit, aplikimi i masave të kërcënimit, terrorit dhe torturës.*



## **PIKA 14**

*Nga 2 gushti 1998 deri në fund të shtatorit 1998, tre të akuzuarit duke vepruar në bashkëpunim me persona të tjerë të paidentifikuar dhe sipas ndërmarrjes së përbashkët penale, kanë marrë pjesë dhe kanë urdhëruar rrahjen dhe torturimin e një serbi të Kosovës të cilin e kanë paraburgosur në qendrat e paraburgimit në Bare, Bajgorë dhe në lokacionet tjera në rrethinë brenda zonës së Llapit me tentativë që ta detyrojnë atë që t'i pranojë veprimet kundër UÇK-së ose të sigurojë informacione të inteligjencës.*

Gjykimi është zhvilluar me lehtësi. Kulminacioni i vëmendjes është arritur kur viktimi serb kosovar (shih Pikën 14 më lartë) është paraqitur para kolegjit për rigjykim për ta dhënë dëshminë e tij; për shkak të nevojës për masa adekuate të sigurisë për mbrojtjen e dëshmitarit dhe përmbajtjes dhe kohëzgjatjes së dëshmisë së dëshmitarit.

Siç është cekur më lart, njëri nga të akuzuarit ka qenë deputet i Kuvendit të Kosovës dhe prandaj ka pasur imunitet sipas nenit 75 të Kushtetutës së Kosovës. Imuniteti i të akuzuarit nuk është kundërshtuar nga i akuzuari apo avokati i tij mbrojtës gjatë gjykimit si kufizim procedural. Sidoqoftë, ka qenë e përshtatshme të sqarohet se, në këtë rast konkret, Kushtetuta e Kosovës nuk e ka penguar zhvillimin e ndjekjes penale për pretendimet specifike. Deputetëve të Kosovës u është dhënë imuniteti funksional i cili sipas paragrafit 1 të nenit 75, i mbulon ata vetëm *për veprimet apo vendimet që janë në kuadër të përgjegjësive të tyre si deputet të Asamblesë, qartazi duke i lënë anash veprimet të cilat nuk janë në funksion të mandatit të deputetit dhe – a fortiori – para marrjes së detyrës së tyre si Deputet i Kuvendit. Krimet e pretenduara në aktakuzë kundër këtij të pandehuri janë kryer në vitin 1999, para marrjes së detyrës si deputet i Kuvendit të Kosovës dhe prandaj pa dyshim jashtë fushëveprimit të paragrafit 1 të nenit 75 të Kushtetutës së Kosovës.*

Aktgjykimi për lëndën grupi i Llapit është shpallur më 2 tetor 2009; Latif Gashi është shpallur fajtor për veprën penale Krime të luftës kundër popullatës civile të përshkruar në pikat e sipërme, sikur në aktakuzën e 30 qershorit 2003. Gjykata ka lëshuar një Urdhër me të cilin i ka shqiptuar Latif Gashit paraburgimin derisa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë dhe ai është arrestuar menjëherë. Urdhri është ankimuar (*shih më poshtë*).

Dy të akuzuarit e tjerë janë shpallur fajtor për veprën penale krime të luftës kundër civilëve të përshkruar në pikat 5 dhe 8, sikur në aktakuzën e 30 qershorit 2003. Tre të akuzuarit janë dënuar me 6, 4 dhe 3 vjet burgim.

### **Ankesa kundër urdhrit për arrest në Gjykatën Supreme të Kosovës:**

Latif Gashi është ankuar kundër urdhrit të trupit gjykues përmes avokatëve të tij mbrojtës. Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin e datës 7 tetor 2009, ka refuzuar ankesën si të pabazuar.

### **Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme:**

Latif Gashi më tutje ka kërkuar mjete të jashtëzakonshme juridike kundër Aktvendimit të Gjykatës Supreme. Më 29 tetor 2009, Latif Gashi përmes avokatëve të tij mbrojtës ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e

ligjshmërisë kundër Aktvendimit të Gjykatës Supreme. I akuzuari ka propozuar anulimin e Aktvendimit të Gjykatës Supreme si dhe të urdhrin për arrest të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës. I akuzuari ka pohuar *inter alia* shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe të Konventës Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Më 19 nëntor 2009, Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë prej tre gjyqtarëve të EULEX-it dhe dy gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës kanë hedhur poshtë si të papranueshme kërkesën e Gashit që kërkonte mjete të jashtëzakonshme juridike kundër Aktvendimit të Gjykatës Supreme të 7 tetorit 2009, duke e refuzuar ankesën e tij kundër urdhrin të trupit gjykues të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të 2 tetorit 2009, duke caktuar paraburgimin e tij. Gjykata Supreme ka vërtetuar se në pajtim me Aktvendimin e GJS-së të 7 tetorit 2009, bazuar në nenin 550 të KPPK-së, ligjit të mëparshëm të procedurës penale, (Ligji i Procedurës Penale - LPP) është i aplikueshëm në këtë lëndë derisa të përfundojë procedura në formën e prerë. Bazuar në nenin 416 të LPP-së, është përgjegjësi unike e prokurorit publik kompetent që të paraqes kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimeve efektive të gjykatës. LPP-ja nuk i siguron të drejtën të pandehurit dhe avokatëve mbrojtës për ta iniciuar procedurën për mbrojtjen e ligjshmërisë. Duke e pas parasysh faktin se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është dorëzuar nga i pandehuri Latif Gashi përmes avokatëve të tij mbrojtës dhe jo nga prokurori publik kompetent, Gjykata Supreme e Kosovës ka konsideruar se nuk ka qenë e lejuar me ligjin e aplikueshëm; prandaj ka qenë e papranueshme.

Kolegji për ankesa i Gjykatës Supreme gjithashtu ka vërtetuar se parimi "ligji më i favorshëm" ka rëndësi vetëm në ligjin penal material, dhe nuk është i aplikueshëm në aspektin procedural.

Përfundimisht, duke iu referuar nenit 353, paragrafit 1 të LPP-së dhe nenit 5 të KEDNJ-së dhe precedentëve të tij, Gjykata Supreme ka konstatuar se Gjykata e Qarkut e Prishtinës ka urdhëruar në mënyrë korrekte paraburgimin kundër Latif Gashit.

### ***Besnik Hasani et al.***

Lënda e përmbledhur më poshtë është e rëndësishme për faktin se të pandehurit kanë qenë dy Policë nga Njësitë Speciale të Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK-së) dhe një ish pjesëtar i Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK-së), dhe akuzat përfshijnë vrasje të rëndë të shumëfishtë të shkaktuar nga shpërthimi.

Të akuzuarit kanë qenë në paraburgim dhe transportimi i tyre nga Qendra e Paraburgimit deri në Gjykatë ishte refuzuar nga Komisionari i Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK), për shkak të rrethanës se të tre të akuzuarit ishin kualifikuar si të burgosur të Kategorisë "A" (*p.sh. Kategori me rrezikshmëri të lartë*) dhe se sipas rregullave të brendshme të ShKK-së nuk ka qenë i mundur transferimi/transportimi i më shumë se një të burgosuri të Kategorisë A për një ditë. Bazuar në këtë kufizim si dhe vlerësimin e përgjithshëm të rrezikut të bërë nga ShKK-ja të gjendjes së sigurisë nëse gjykimi do të mbahej në Prishtinë, gjykimi përfundimisht është mbajtur në Qendrën e Paraburgimit në Dubravë ku edhe ishin duke u mbajtur të pandehurit.

Pas shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë i përbërë prej dy gjyqtarëve të EULEX-it dhe një gjyqtari vendor ka shpallur dy Policët fajtor për veprat penale vrasje e rëndë, lëndime të rënda trupore, dhe shkaktim i rrezikut të përgjithshëm, të gjitha krimet ishin kryer në bashkëkryerje (të përshkruara më poshtë pikat 2, 3 dhe 4 të aktakuzës origjinale).



## **PIKA 2**

Më 24 shtator 2007, dy policët duke vepruar në bashkëkryerje me njëri tjetrin dhe me individë të tjerë identiteti i të cilëve është ende i panjohur, kanë privuar nga jeta persona tjerë për shkak të hakmarrjes së paskrupullt dhe motiveve tjera të ulëta, duke e vendosur dhe shpërthyer një mjet të improvizuar shpërthyes në katin përdhes të një ndërtese në Avenynë Bill Kllinton në Prishtinë, e cila ka rezultuar në vdekjen e dy personave, dhe duke vepruar në atë mënyrë ata qëllimisht kanë rrezikuar jetën e më shumë personave, në këtë mënyrë kanë kryer veprën penale *vrasje e rëndë*.

## **PIKA 3**

Më 24 shtator 2007, duke vepruar në bashkëkryerje me njëri tjetrin dhe me individë të tjerë identiteti i të cilëve është ende i panjohur i kanë shkaktuar lëndime të rënda trupore nëntë personave, duke e vendosur dhe shpërthyer një mjet të improvizuar shpërthyes në katin përdhes të një ndërtese në Avenynë Bill Kllinton në Prishtinë, në këtë mënyrë kanë kryer veprën penale *lëndime të rënda trupore*.

## **PIKA 4**

Më 24 shtator 2007, dy të pandehurit ( Policët) duke vepruar në bashkëkryerje me njëri tjetrin dhe me individë të tjerë identiteti i të cilëve është ende i panjohur duke përdorur eksploziv, përkatësisht një mjet të improvizuar shpërthyes të vendosur dhe të shpërthyer, në katin përdhes të një ndërtese në Avenynë Bill Kllinton në Prishtinë, kanë shkaktuar rrezik të madh ndaj jetës së njeriut që ka rezultuar në vdekjen e dy personave dhe lëndime të rënda trupore të nëntë personave, në këtë mënyrë duke kryer veprën penale *shkaktim i rrezikut të përgjithshëm*.

I pandehuri i tretë është shpallur i pafajshëm lidhur me veprat penale të listuara më lartë dhe prandaj është liruar.

Aktgjykimi është shpallur më 17 shtator 2009. Gjykata e Qarkut në Prishtinë ka dënuar dy të pandehurit e shpallur fajtor me burgim afatgjatë prej 25 vjet për secilin.

## **Gjykata e Qarkut në Pejë**

### ***Idriz Gashi***

### **Përmbledhje e procedurës penale**

#### **Aktakuza, 2007:**

Aktakuza kundër Idriz Gashit është paraqitur më 08.02.2007, duke e akuzuar të pandehurin për krime të luftës kundër popullatës civile. Sipas aktakuzës, në mëngjesin e 12 gushtit 1998, një grua shqiptare e Kosovës është marrë në pyetje nga pjesëtarët e UÇK-së që kontrollonin zonën e fshatit Barane, pastaj ajo është marrë nga Idriz Gashi dhe një pjesëtar tjetër i UÇK-së dhe është dërguar në një zonë të pyllëzuar në afërsi të fshatit Vranoc, komuna e Pejës, ku Idrizi e qëllloi atë për vdekje sepse ai e konsideronte atë si bashkëpunëtorë e serbëve.

## **Shqyrtimi gjyqësor, 2007:**

Shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në hapësirat e Gjykatës së Qarkut në Pejë, nga një kolegji i përbërë prej dy gjyqtarëve ndërkombëtarë të (UNMIK-ut) dhe një gjyqtari vendor. I pandehuri është shpall fajtor dhe është dënuar me pesëmbëdhjetë (15) vjet burgim.

## **Ankesa, 2009:**

Më 2 qershor 2009, kolegji i Gjykatës Supreme i përbërë prej dy gjyqtarëve të EULEX-it dhe tre gjyqtarëve vendor ka kthyer mbrapa aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe ka dërguar lëndën në rigjykim në të njëjtën Gjykatë të Qarkut. Me një aktvendim të ndarë paraburgimi kundër të pandehuri Idriz Gashi është zëvendësuar me arrest shtëpiak.

## **Rigjykimi, 2009:**

Shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në Gjykatën e Qarkut në Pejë në fund të tetorit dhe në fillim të nëntorit 2009. Trupi gjykues ka qenë i përbërë prej dy gjyqtarëve të EULEX-it dhe një gjyqtari vendor të Gjykatës së Qarkut.

Siç është cekur më lartë, sipas aktakuzës së paraqitur më 8 shkurt 2007, i pandehuri është akuzuar për Krime të luftës kundër popullatës civile në kundërshtim të nenit 142 të KP të RSFJ-së.

Pas shqyrtimeve publike më 21, 29 dhe 30 tetor 2009 dhe më 12, 17 dhe 19 nëntor 2009, në prani të të akuzuarit, avokatit të tij mbrojtës, Prokurorit të EULEX-it dhe palës së dëmtuar, dhe pas këshillimit, trupi gjykues ka bërë shpalljen publike të aktgjykimin më 19 nëntor 2009.

I pandehuri është shpallë fajtor për veprën penale krime të luftës kundër popullatës civile në kundërshtim të nenit 142 të KP të RSFJ-së, neneve 3 dhe 147 të Konventës së katërt të Gjenevës, dhe nenit 4 të Protokollit shtesë të Konventave të Gjenevës të datës 12 gusht 1949. I pandehuri është dënuar me 14 (katërmëdhjetë) vjet burgim. Me një aktvendim të ndarë është caktuar paraburgimi kundër të pandehurit.

## **Ankesa në Gjykatën Supreme kundër aktvendimit mbi paraburgimin**

I pandehuri Idriz Gashi ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër aktvendimit mbi paraburgim të Gjykatës së Qarkut në Pejë. Më 26 nëntor 2009, kolegji i përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtari vendor kanë pranuar pjesërisht ankesën duke i shqiptuar të pandehurit arrest shtëpiak në vend të paraburgimit derisa aktgjykimi kundër tij të bëhet i formës së prerë.



## **Gjelosh Krasniqi**

Gjelosh Krasniqi është akuzuar për veprën penale Krime të luftës kundër popullatës civile në kundërshtim me nenin 142 të KP të RSFJ-së, neneve 3 dhe 147 të Konventës së katërt të Gjenevës, dhe nenit 4 të Protokollit shtesë të Konventave të Gjenevës të datës 12 gusht 1949. Akuzat kanë përfshirë veprime të arrestimit ilegal, paraburgimi, marrja peng, privimin nga e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, trajtim çnjerëzor dhe vrasja e një personi civil shqiptar të Kosovës; konfiskim i paligjshëm i pronës dhe plaçkitja e armës nga viktimat dhe civilëve tjerë shqiptarë të Kosovës. Veprat pretendohet të jenë kryer më 24 mars 1999 në fshatin Doblbarë, komuna e Gjakovës. Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor nga 11 deri më 31 mars 2009, dhe 23 deri më 29 prill 2009, trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut në Pejë i përbërë prej dy gjyqtarëve të EULEX-it dhe një gjyqtari vendor ka shpallur aktgjykimin më 29 prill 2009.

Duke u mbështetur në vendimin e kolegjit, akuzat kundër Gjelosh Krasniqit për kryerjen e veprës penale Krime të luftës kundër popullatës civile sa i përket arrestimit ilegal të viktimës është ri-cilësuar si privim i kundërligjshëm nga liria në kundërshtim të nenit 162 të KPK-së dhe si pasojë e ka refuzuar pasi që kishte skaduar periudha e parashkrimit. I pandehuri është liruar sa i përket paraburgimit, privimi i të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, trajtim çnjerëzor dhe vrasje të viktimës sepse nuk është dëshmuar se i akuzuari ka kryer veprën për të cilën akuzohej.

I pandehuri është shpall fajtor për Krime të luftës kundër popullatës civile sa i përket marrjes së viktimës peng dhe konfiskim i kundërligjshëm i pronës dhe plaçkitje të armëve. Prandaj Gjelosh Krasniqi është dënuar me kohëzgjatje prej shtatë (7) vjet burgim.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar nga prokurori publik dhe ankesa është tani në pritje në Gjykatë Supreme.

## **Gjykata e Qarkut në Prizren**

### ***Andjelko Kolasinac***

Më 4 nëntor 2009, kolegji i Gjykatës së Qarkut në Prizren i përbërë prej dy gjyqtarëve të EULEX-it dhe një gjyqtari vendor ka shpallur aktvendimin në lëndën kundër Andjelko Kolasinac. Ky ishte rigjykimi i dytë kundër këtij të pandehuri Serb i Kosovës i cili është gjykuar dhe dënuar dy herë më parë për krime të luftës kundër popullatës civile.

Aktakuza kundër Andjelko Kolasinac është paraqitur më 7 gusht 2000. Aktakuza ka emëruar Andjelko Kolasinac dhe shtatë të pandehur të tjerë dhe la pretenduar se secili i pandehur kishte kryer vepër penale Krime të luftës kundër popullatës civile. Më 2 shtator 2000, gjashtë të pandehurit e akuzuar përveç Kolasinacit dhe një të pandehuri tjetër kanë ikur nga qendra e paraburgimit në të cilin mbaheshin. Prokurori publik ka propozuar të ndahet lënda e Kolasinac dhe të pandehurve të tjerë nga ata të pandehur të cilët kanë ikur. Si pasojë, trupi gjykues ka vendosur të gjykojë vetëm Kolasinacin dhe të pandehurin tjetër i cili nuk kishte ikur.

Gjatë majit dhe qershorit 2001, lënda është gjykuar pranë një kolegji të gjyqtarëve ndërkombëtarë të

(UNMIK-ut). Më 14 qershor 2001, Gjykata e Qarkut ka shpallur aktgjykimin duke e shpallë Kolasinacin fajtor për veprën penale "Ndihmë kryerësit pas kryerjes së veprës penale", duke organizuar fshehjen e gjurmëve të krimeve të luftës të dëbimit të shqiptarëve të Kosovës duke organizuar shkatërrimin dhe heqjen e mbetjes së pronave të tyre dhe gjësendeve personale në Malishevë gjatë prillit dhe majit 1999. Gjykata ka dënuar Kolasinacin me pesë (5) vjet burgim.

Në gusht 2001, Prokurori publik ndërkombëtar dhe avokati mbrojtës vazhdimisht kanë paraqitur ankesa kundër aktgjykimit. Më 2 nëntor 2001, Gjykata Supreme e Kosovës ka anuluar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren dhe ka kthyer lëndën në rigjykim.

Më 31 janar 2003, Gjykata e Qarkut në Prizren ka shpallur Andjelko Kolasinac fajtor për Krime të luftës kundër popullatës civile lidhur me "zhvendosjen apo depërtimin e dhunshëm përmes regjistrimit", "punë të dhunshme", "plaçkitje dhe vjedhje të pronave të popullatës përfshirë"<sup>9</sup>. Gjykata e ka dënuar atë me tetë (8) vjet burgim.

Më 5 gusht 2004, Gjykata Supreme ka aprovuar ankesat e avokatit mbrojtës të Andjelko Kolasinac, ka kthyer aktgjykimin e mëparshëm dhe ka dërguar lëndën në rigjykim.

Rigjykimi në lëndën kundër Kolasinac është hapur në Gjykatën e Qarkut në Prizren më 4 nëntor 2009. Prokurori i EULEX-it i deleguar për procedura penale ka dorëzuar një aktakuzë të ndryshuar duke e ricalësuar veprën ende kundër të akuzuarit pas vendimit të Gjykatës Supreme të 5 majit 2004, si abuzim i besimit – e kryer në shkelje të nenit 148 të LPK-së – dhe e dënueshme prej tre muaj deri në tri vjet burgim. Prokurori më tutje ka dorëzuar se parashkrimi vlen për veprën e keqpërdorimit të besimit. Gjykata ka refuzuar akuzat kundër të akuzuarit sepse krimi keqpërdorimi i besimit e deklaruar në aktakuzën e ndryshuar janë mbuluar me parashkrim. Asnjëra nga palët nuk ka paraqitur ankesë kundër këtij vendimi.

## **b) Lëndët e trazirave të marsit 2004**

### **Gjykata Supreme**

Në gjashtë lëndët penale të lidhura me ngjarjet e marsit 2004 janë përfunduar gjykimet dhe prandaj i janë transferuar gjyqtarëve të EULEX-it në Gjykatën Supreme. Të gjitha gjashtë lëndët janë përfunduar (në një të ankesa është tërhequr). Më poshtë është përmbledhja e procedurave në katër prej këtyre lëndëve.

### ***Skënder Islami et alia***

Gjykimi në këtë lëndë ka mbaruar më 25 janar 2008 në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Të pandehurit janë shpallë fajtor për veprën penale përfshirë pjesëmarrje në grup që kryen vepër penale. Kjo lëndë ka të bëjë me trazirat e 17 marsit 2004 në Fushë Kosovë. Nga një grup prej pesë të pandehurve Skender Islami (i dënuar me tetë vjet) dhe edhe një i pandehur (i dënuar me shtatë vjet) ishin në paraburgim në Dubravë derisa tre të pandehurit e tjerë kanë qenë të lirë në pritje të ankesës.

9 Shih Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren, *Andjelko Kolasinac*, 4 nëntor 2008



Lënda i është transferuar gjyqtarëve të EULEX-it në Gjykatën Supreme më 20 janar 2009. Kolegji i Gjykatës Supreme i përbërë prej dy gjyqtarëve të EULEX-it dhe një gjyqtari vendor ka shpallur aktgjykimin më 20 tetor 2009 dhe pjesërisht ka pranuar ankesat e katër të pandehurve përfshirë edhe Skender Islamit, dhe ka liruar të pandehurin e pestë nga të gjitha akuzat e ngritura kundër tij. Skender Islamit, Gjykata Supreme i ka shqiptuar dënimin prej tre (3) vjet dhe gjashtë muaj burgim. Për dy nga tre të pandehurit e mbetur të shpallur fajtor, Gjykata ka shqiptuar dënim prej një (1) vit dhe gjashtë muaj dhe për të pandehurin e tretë dënimi ka qenë dy (2) vjet e gjashtë muaj burgim. Koha e kaluar në paraburgim është përfshirë në kohëzgjatjen e dënimit. Gjykata më tutje ka vendosur se katër të pandehurit së bashku duhet t'i kompensojnë shpenzimet e procedurës. Gjykata gjithashtu ka revokuar vendimin e shkallës së parë mbi kërkesat pronësore dhe ka udhëzuar palët e dëmtuara që t'i ushtrojnë kërkesat e tyre pronësore në procedurë civile.

Argumentet kryesore për vendimin e kolegjit të Gjykatës Supreme janë përmbledhur nga Kryetari i kolegjit i EULEX-it si në vijim:

1) Deklaratat në të cilat është bazuar vendimi i shkallës së parë ishin dhënë nga të miturit në cilësi të të dyshuarve pa ndihmën e avokatëve mbrojtës që ka qenë e detyrueshme. Si pasojë, ato kanë qenë tërësisht të kundërligjshme dhe nuk duhet të përdoren as për kundërshtimin e deklaratave të dëshmitarëve dhe të pandehurve e as për bazimin e rikonstruktimit të fakteve;

2) Vepra penale e pjesëmarrjes në grup nuk mund të bashkohet me veprën më të rëndë të shkakimit të rrezikut të përgjithshëm por duhet që të konsumohet në të.

### ***Sadri Shabani et alia***

Sadri Shabani dhe pesë të pandehurit e tjerë të akuzuar me vrasje të rëndë, shkaktim të rrezikut të përgjithshëm, pjesëmarrje në grupin që kryen veprë penale, mbajtje e paligjshme e armëve dhe e municionit dhe pengim i dëshmitarëve. Këto pohime kishin të bënin me vrasjen e një serbi kosovar dhe me plagosjen e rëndë të nënës së tij gjatë trazirave të marsit 2004 në Gjilan.

Gjykata e Qarkut të Gjilanit si gjykatë e shkallës së parë ka shpallur të pandehurit fajtorë për pjesëmarrje në grupin që ka privuar viktimën nga jeta, që i kanë shkakuar lëndime të rënda trupore nënës së tij dhe që kanë dëmtuar në masë të konsiderueshme shtëpinë e viktimës dhe së paku një veturë.

Dënimet shkonin nga 16 vjet deri në 2 vjet e 6 muaj burgim. Përveç njërit, të gjithë të pandehurit janë ankuar kundër aktgjykimin; ankesat e tyre janë dëgjuar në Gjykatën Supreme më 23 qershor 2009. Kolegji i Gjykatës Supreme i përbërë prej tre gjyqtarësh të EULEX-it dhe dy gjyqtarëve kosovarë ka refuzuar ankesat e tre të pandehurve dhe ka pranuar pjesërisht ankesat e dy të tjerëve. Një nga këto ankesa është pranuar lidhur me cilësimin juridik të veprës penale të vrasjes së rëndë. Ankesa e dytë është pranuar pjesërisht lidhur me veprën penale të ndihmës në vrasjen e rëndë, nga e cila është liruar i pandehuri dhe është ulur dënimi i tij.

### ***Gëzim Ferati***

Më 8 shtator 2009, kolegji i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga tre gjyqtarë të EULEX-it dhe dy gjyqtarë kosovarë të Gjykatës Supreme të Kosovës, ka mbajtur seancën për të vendosur mbi ankesën e

Prokurorit Publik, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, të datës 11 maj 2006, të lëshuar në lëndën penale kundër Gëzim Feratit. Ankesa e Prokurorit Publik është refuzuar dhe aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Gëzim Ferati është ngarkuar me dy pika të vrasjes së rëndë të kryer në bashkëpunim dhe me katër pika të vrasjes së rëndë në tentativë në bashkëpunim, lidhur me ngjarjet që u zhvilluan gjatë trazirave të marsit 2004 në fshatin Drekok, komuna Shtërpçë.

Kishte pohime sipas të cilave, më 17 mars 2004, i pandehuri, i motivuar nga urrejtja dhe paragjykimi kombëtar, hakmarrja dhe ligësia mizore, në bashkëpunim me së paku pesë (5) persona të paidentifikuar, ka qëlluar dy persona të kombësisë serbe jashtë shtetësisë së tyre. Njëri prej viktimave ka vdekur në vendngjarje përdërisa i dyti ka vdekur gjatë transportit për në spital për trajtim mjekësor. I pandehuri Gëzim Ferati dhe bashkëkryerësit e tij kanë qëlluar në viktimat vetëm pse ata ishin serbë; dhe në të njëjtën kohë kanë rrezikuar jetën e personit të tretë, e cila ka qenë në shtëpi në kohën e të shtënave, pasi që edhe ajo ka mundur të qëllohej nga plumbat. Më 17 mars 2004, i pandehuri Gëzim Ferati, në bashkëpunim me së paku pesë (5) individë të paidentifikuar, pohohet se ka qëlluar në katër policë serbë të ShPK-së, të cilët kishin ardhur me qëllim të sigurimit të vendit të krimit. Këta policë janë qëlluar gjatë kryerjes së detyrës së tyre zyrtare.

Kolegji ndërkombëtar i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, i përbërë nga tre gjyqtarë të UNMIK-ut, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/64, në aktgjykimin e lëshuar më 11 maj 2007, ka liruar Gëzim Feratin nga të gjitha akuzat për shkak të dëshmimeve të pamjaftueshme. Kundër këtij aktgjykimi, Prokurori Publik ka ushtruar ankesë në dëm të të pandehurit.

Më 6 janar 2009, lënda është kaluar nga UNMIK-u tek gjyqtarët e EULEX-it dhe pas vlerësimit të saj, lënda është përzgjedhur në kompetencën e gjyqtarëve të EULEX-it në Gjykatën Supreme.

Siç është përmendur edhe më lart, më 8 shtator 2009, Gjykata Supreme ka mbajtur seancën për të vendosur lidhur me ankesën. Aktgjykimi është shpallur më 15 shtator 2009. Kolegji ka refuzuar si të pabazë ankesën e Prokurorit Publik kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, dhe për këtë arsye ka vërtetuar aktgjykimin.

Kjo lëndë se ka qenë lënda e parë në të cilën aktgjykimi i Gjykatës Supreme është shpallur në mënyrë publike gjatë seancës gjyqësore. Praktika e shpalljes publike të aktgjykimit në lëndët penale është filluar në Gjykatën Supreme nga ana e gjyqtarëve të EULEX-it, pas një vlerësimi të thellë të legjislacionit të Kosovës në frymën e KEDNj-së dhe në jurisprudencë të vazhdueshme me Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Duke u bazuar në këshillat e gjyqtarëve të EULEX-it, Kryetari i Gjykatës Supreme vullnetarisht ka miratuar këtë praktikë.

### ***Mehmet Morina***

Gjykata Supreme ka shpallur vendimin e saj në lëndën e Mehmet Morinës më datën 19 maj 2009. Aktgjykimi i shkallës së parë është ndryshuar nga kolegji i Gjykatës Supreme i përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe tre gjyqtarë kosovarë të Gjykatës Supreme.



Gjykata e Qarkut të Prishtinës në aktgjykimin e saj të datës 2 korrik 2005, ka shpallur Mehmet Morinën fajtor për veprën penale të vrasjes së rëndë në tentativë, duke vepruar në bashkëpunim me persona të tjerë dhe duke ndihmuar dhe duke mbështetur njëri tjetrin, të kryer në mënyrë brutale ose tinëzare, të papërmbytur dhe të dhunshme, lidhur me trazirat e marsit 2004; ndërsa ka shfajësuar të njëjtin për akuzën e pjesëmarrjes në grup që kryen vepër penale. Më konkretisht, Morina është akuzuar për vrasje të rëndë në tentativë të një serbi kosovar, ditën e parë të trazirave të marsit 2004 në zonën e Bresjes në Fushë Kosovë, duke e goditur me shufër metali me të dy duart sikur kur kapet sëpata gjatë çarjes së druve me një forcë të madhe. Viktima nuk kishte vdekur menjëherë por persona të paidentifikuar i kishin vënë zjarrin pasi e kishin sulmuar dhe ai kishte vdekur si pasojë e kësaj. Mehmet Morina ishte dënuar me 18 vjet burgim, në të cilin ishte llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim që nga data 19 prill 2004.

Prokurori publik ka paraqitur ankesë në dëm të Mehmet Morinës duke kërkuar nga kolegji ankimor që ta shpallin fajtor për kryerje të vrasjes së rëndë në vend të vrasjes së rëndë në tentativë, dhe që ta ndryshojnë aktgjykimin e shkallës së parë në përputhje me këtë. I pandehuri po ashtu ka ushtruar ankesë kundër aktgjykimit përmes avokatit të tij mbrojtës duke pasur si qëllim shfajësimin e vet ose shqiptimin e një dënimi më të butë kundër tij.

Gjykata Supreme ka refuzuar ankesën e Prokurorit publik dhe pjesërisht ka pranuar ankesën e të pandehurit ashtu që Gjykata Supreme ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës me:

- ndryshimin e cilësimit të veprës penale në Vrasje të rëndë në tentativë në bashkëpunim me personat e tjerë, të kryer në mënyrë të ligë, dhe
- uljen e dënimit nga 18 vjet në 12 vjet burgim.

Pjesa tjetër e aktgjykimit të shkallës së parë është vërtetuar nga Gjykata Supreme.

Një nga anëtarët e kolegjit ankimor të Gjykatës Supreme (gjyqtar i EULEX-it) ka paraqitur mendimin e tij mospajtues për aktgjykimin, duke argumentuar se vepra penale e Mehmet Morinës është dashur që të cilësohet **si** Vrasje dhe se Mehmet Morina është dashur që të shpallet fajtor **për** Vrasje e jo për vrasje në tentativë.

I pandehuri përmes avokatit të tij mbrojtës ka paraqitur një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë. Prokurori i EULEX-it po ashtu paraqitur një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në dëm të të pandehurit. Kolegji i Gjykatës Supreme i përbërë prej dy Gjyqtarëve të EULEX-it dhe tre Gjyqtarëve Kosovarë refuzoi të dyja kërkesat dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Supreme të datës 19 maj 2009.

\*\*\*

Lëndët me akuza që kanë të bëjnë me trazirat e marsit 2004 po ashtu janë pranuar edhe nga gjyqtarët penalë të EULEX-it në nivelin e Gjykatës së Qarkut. Një lëndë e tillë penale e cila pas kalimit të saj në EULEX më 24 dhjetor 2008 është kaluar tek gjyqtarët e EULEX-it në Gjykatën e Qarkut të Prizrenit, ishte edhe lënda kundër Gani Hazirajt, përmbledhja e së cilës është e dhënë më poshtë.

## **Gani Haziraj**

Në aktakuzën e ngritur më 14 korrik 2008, i pandehuri është ngarkuar me tri vepra: Pjesëmarrje (si udhëheqës) në grupin që kryen veprën penale, të përcaktuar me nenin 200(2) të LPK-së; Pjesëmarrje në grupin që kryen veprën penale, të përcaktuar me nenin 200(1) të LPK-së; dhe Nxitje, të përcaktuar me nenin 23 të KP të RSFJ-së.

Këto akuza kanë të bëjnë me veprat penale që pohohen të jenë kryer në Prizren më 17 dhe 18 mars 2004 e që kanë rezultuar në shtëpi dhe kisha ortodokse serbe të djegura si dhe në dëme të konsiderueshme materiale. Gjatë këtyre ngjarjeve janë lënduar disa policë. Pohimet materiale kanë konstatuar se më 17 dhe 18 mars 2004, i pandehuri ka marrë pjesë si udhëheqës i turmës së mbledhur e cila me veprimet e përbashkëta ka shkaktuar dëme të shkallës së gjerë në prona. Gjatë konfirmimit të aktakuzës, i pandehuri ka mohuar të ketë marrë pjesë në protestat e dhunshme të datës 17 mars 2004, duke pohuar se gjatë asaj kohe ai kishte qenë në një vend tjetër. Ai ka pranuar se ka qenë i pranishëm në protestën e 18 marsit 2004, duke pohuar megjithatë se nuk kishte marrë pjesë në mënyrë të dhunshme, ashtu siç pohohej kundër tij.

Kishte dëshmi të shumta në dosjen e gjykatës, duke përfshirë foto, deklaratat të dëshmitarëve, dhe raporte policore të cilat pohonin të kenë provuar rolin e të pandehurit si udhëheqës në protesta. I pandehuri pohohej të ishte paraqitur në disa foto që e tregonin duke i prirë turmës në marshimin drejt institucioneve të UNMIK-ut më 18 mars 2004. Ai ishte paraqitur në disa foto teksa si duket po udhëzonte masën. Dëshmitë e prokurorisë lidhur me pjesëmarrjen e të pandehurit në veprën e pohuar penale ishin mbështetur me deklaratat e katër dëshmitarëve.

Trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut të Prizrenit ishte i përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar kosovar. Shqyrtimet publike u mbajtën në qershor dhe shtator 2009, në praninë e Prokurorit të EULEX-it, të akuzuarit Gani Haziraj dhe të avokatit të tij mbrojtës. Gjykimi ka përfunduar më 28 shtator 2009 kur është shpallur publikisht aktgjykimi. I pandehuri është shpallur fajtor për një vepër më të lehtë penale të pjesëmarrjes në tubimin që ka shkaktuar dhunë sipas nenit 200(1) të LPK-së. Gjykata i ka shqiptuar dënimin me burgim prej 6 muajsh, ekzekutimi i të cilit është pezulluar për një vit.

## **Ankesa kundër aktgjykimit në Gjykatën Supreme:**

I pandehuri ka ushtruar ankesë ndaj aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës. Kolegji i GJS-së i përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar kosovar i GJS-së ka vendosur mbi ankesën më 19 janar 2010.

Gjatë shqyrtimit të pretendimeve të ankesës lidhur me shkeljet e ligjit penal dhe të procedurës në shkallën e parë, GJS-ja nuk ka gjetur "asnjë shkelje ... sa i përket përbërjes së gjykatës së shkallës së parë dhe të pjesëmarrjes së gjyqtarëve në shqyrtimin gjyqësor dhe në lëshimin e ... aktgjykimit...", lidhur me kompetencat e gjykatës së njëjtë..."<sup>10</sup>. Për më tepër, "shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në praninë e të akuzuarit dhe të avokatit të tij mbrojtës" siç përcaktohet me KPPPK. GJS-ja ka shqyrtuar pretendimin e avokatit mbrojtës se "për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike ligji material është miratuar gabimisht..." dhe nuk ka gjetur "asnjë shkelje të ligjit penal ... në aktgjykimin e parë i cili ka vërtetuar përgjegjësinë e të pandehurit për krimin e ngarkuar ..."<sup>11</sup>. Gjykata ka konstatuar se "koncepti i

10 *Shih Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Gani Haziraj, 19 janar 2010*

11 Fusnota 9



përgjegjësisë penale [ishte] zbatuar në mënyrë të duhur në aktgjykimin e kundërshtuar.”<sup>12</sup> Kolegji ankimor ka konstatuar se pretendimet e avokatit mbrojtës lidhur me shkeljen themelore të procedurës penale; vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljen e ligjit penal ishin të pabazuara. Kolegji ankimor për këtë arsye ka refuzuar ankesën e të pandehurit dhe ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë në tërësinë e tij.

\*\*\*

Përmbledhjet e sipërpërmendura kanë treguar natyrën komplekse të lëndëve penale të trashëguara nga UNMIK-u. Këto lëndë përmbanin akuza të shumta penale duke përfshirë këtu pjesëmarrje në grupin që kryen veprën penale; vrasje dhe vrasje të rëndë në bashkëpunim me persona të tjerë, të kryer në mënyrë të ligë, në mënyrë brutale ose tinëzare, të papërmbajtur dhe të dhunshme; mbajtje të paligjshme të armëve dhe të municionit; shkaktim të rrezikut të përgjithshëm; etj. Të 20 lëndët penale të trashëguara nga UNMIK-u në nivelin e Gjykatës Supreme tashmë janë mbyllur. Aktgjykimi i fundit në një lëndë të tillë është lëshuar nga GjS-ja më 19 janar 2010. Përfundimi i trashëgimisë së UNMIK-ut në GjS është arritur në bashkëpunim të ngushtë me gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Kosovës. Gjyqtarët e EULEX-it në Gjykatën e Qarkut dhe kolegjet e tyre vendorë po ashtu janë duke përparuar në drejtim të duhur të arritjes së këtij qëllimi, dhe pritjet që lëndët e UNMIK-ut në të gjitha GjQ-të të kryhen në gjysmën e parë të vitit 2010.

Paragrafët në vazhdim të këtij kapitulli do të ofrojnë një pasqyrë të lëndëve të cilat nuk kanë qenë pjesë e trashëgimisë së UNMIK-ut, por prapëseprapë janë marrë dhe janë gjykuar nga gjyqtarët e EULEX-it gjatë ushtrimit të kompetencës së tyre sekondare në procedurat penale në përputhje me *Ligjin mbi kompetencat*.

## **2) Ushtrimi i autorizimeve të Kryetares së Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it sipas Ligjit mbi kompetencat – analizë e vendimeve dhe të dhëna statistikore**

### **a) Baza ligjore e autorizimeve të Kryetares së Gjyqtarëve të EULEX-it**

Siç është sqaruar më herët në këtë raport, gjyqtarët e EULEX-it ushtrojnë funksione gjyqësore në gjykatat e Kosovës në përputhje me *Ligjin mbi kompetencat* që u jep gjyqtarëve të EULEX-it kompetencë primare (ose ekskluzive) dhe kompetencë shtesë. Kompetenca shtesë e gjyqtarëve të EULEX-it ushtrohet vetëm kur krimi në fjalë nuk është hetuar apo ndjekur penalisht nga PSRK-ja.

Kompetenca shtesë mund të ushtrohet me kërkesën e Prokurorit të EULEX-it të caktuar në lëndë, ose me kërkesën e palëve në procedurë, ose me kërkesën me shkrim të Kryetarit të gjykatës kompetente “kur dispozitat të cilat kanë të bëjnë me përjashtimin e një gjyqtari ... nuk janë të zbatueshme”<sup>13</sup>. Në rast të një kërkesë të tillë, Kryetares së Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it i jepet e drejta për çfarëdo arsye “kur të konsiderohet e nevojshme për sigurimin e zbatimit të duhur të drejtësisë” që të caktojë në procedurën gjyqësore gjyqtarë të EULEX-it.<sup>14</sup> Kryetarja e gjyqtarëve të EULEX-it mund të ushtrojë të drejtën e caktimit të gjyqtarit të EULEX-it për “çfarëdo vepre penale”.<sup>15</sup>

12 Fusnota 9

13 Neni 3.3, *Ligji mbi kompetencat*

14 Neni 3.3, *Ligji mbi kompetencat*

15 Neni 3.6, *Ligji mbi kompetencat*

Neni 3.5 i *Ligjit mbi kompetencat* interpreton "nevojën e sigurimit të zbatimit të duhur të drejtësisë". Sipas këtij neni, gjyqtarët e EULEX-it mund të ndërhyjnë "po qe se ka pasur kërcënime të gjyqtarëve kosovarë, të dëshmitarëve ose të palëve në procedurë lidhur me rastin, dhe kjo mund të shpie arsyeshëm në besimin se do të kishte keqpërdorim serioz të drejtësisë nëse lënda mbetet nën përgjegjësinë ekskluzive të gjyqtarëve të Kosovës." Sipas dispozitës së njëjtë të LmK-së, kushti i dytë për caktimin e gjyqtarëve të EULEX-it në procedurë penale është "nëse është e arsyeshme të besohet se aktiviteti i gjyqtarit të EULEX-it, për shkak të natyrës së veçantë komplekse të lëndës, është i nevojshëm për t'i ikur keqpërdorimit të drejtësisë."

Neni 5 i LmK-së u jep gjyqtarëve të EULEX-it kompetenca shtesë në (1) lëndët që bien nën kompetencën e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit dhe (2) lëndët që bien nën kompetencën e çdo gjykate të Kosovës lidhur me ankesat mbi vendimet e Komisionit Kosovar për Kërkesa Banesore Pronësore, Kompetenca e dytë shtesë kufizohet në lëndët që kanë të bëjnë me pronën nëse ekziston dyshimi i bazuar se gjyqësori vendor nuk është në gjendje të gjykojë lëndën e caktuar drejt. Nuk ekziston një dispozitë lidhur me atë se kush ka të drejtën e paraqitjes së kërkesës mbi "marrjen përsipër" të lëndës nga EULEX-i. Në praktikë, janë pala në procedurë, kryetari i kolegjit, kryetari i gjykatës apo gjyqtari i EULEX-it gjatë aktivitetit të tij/saj e MUK-ut, ata që adresojnë kërkesën te Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it

Më 2 mars 2009, Zyra e Kryetares së Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it (ZKGJE) ka nxjerrë Procedurat Standarde Operative (PSO), të cilat kishin si qëllim sqarimin në hollësi të kushteve dhe të procedurës që duhet të ndiqet gjatë marrjes së një lënde civile apo penale, në pajtim me nenet 3 deri në 5 të *Ligjit mbi kompetencat*.

Procedura e përcaktuar me PSO parashikon që kërkesat për caktimin e një gjyqtari të EULEX-it në procedurën penale apo civile duhet t'i dorëzohen ZKGJE-së dhe të gjitha ekipeve të GjQ-ve. Procedura që pason pas dorëzimit të kërkesës përfshin fazën e procedurës paraprake dhe fazat e mëvonshme të procedurës penale. PSO përmend nenin 3.6 të *Ligjit mbi kompetencat* që përcakton të drejtën e "gjyqtarit kosovar që përndryshe duhet t'i jetë caktuar lënda, kryetarit të gjykatës kompetente apo të gjykatës së instancës më të lartë dhe të palëve në procedurë" që të dëgjohen nga Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it. Siç parashihet me PSO, vendimi mbi caktimin e shqyrtimit duhet të merret nga Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it. Vendimi duhet që t'i komunikohet ekipit përkatës të EULEX-it në GjQ, i cili pastaj duhet ta sigurojë dorëzimin e tij tek palët pa asnjë vonesë dhe jo më vonë sesa katër ditë para shqyrtimit të caktuar.

PSO-ja për caktimin e gjyqtarëve të EULEX-it në procedurë penale dhe civile merr parasysh çështjen e publicitetit të shqyrtimeve për kalimin e lëndëve, e cila nuk është rregulluar me *Ligjin mbi kompetencat*. PSO-ja nënvizon se publiciteti është parimi kryesor që zbatohet kur bëhet fjalë për gjykimet. Megjithatë, duke marrë parasysh karakterin ndryshe të shqyrtimeve sipas nenit 3.6 të *Ligjit mbi kompetencat*, PSO-ja konstaton se ky lloj shqyrtimi nuk ka nevojë për publicitet, dhe për këtë arsye shqyrtimet për kalimin e lëndëve nuk konsiderohen të jenë publike.

Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it duhet "që t'ia ofrojë kryetarit të gjykatës që ka kompetencë dhe palëve të procedurës arsyet e vendimit për pranimin apo refuzimin e kërkesës për të caktuar një gjyqtar të EULEX-it në një procedurë të veçantë."<sup>16</sup> Neni 3.6 i *Ligjit mbi kompetencat* përcakton se nuk lejohet ankesa kundër vendimit të Kryetares së Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it.



## **b) Kërkesat për marrjen e lëndëve penale - statistika dhe analiza**

Gjatë periudhës janar 2009 deri në janar 2010, janë pranuar gjithsej 89 kërkesa për marrjen e lëndëve qoftë civile apo penale. Nga ky numër 53 kërkesa kishin të bënin me lëndë penale ndërsa 11 me lëndë civile. Këto lëndë ishin nën kompetencën e gjykatave të qarkut dhe atyre komunale në të gjitha rajonet e Kosovës dhe Gjykata Supreme e Kosovës i ka caktuar si vijon:

- Prishtinë – 21 kërkesa nga të cilat 15 kanë të bëjnë me lëndë penale, ndërsa 6 janë civile;
- Pejë - 34 kërkesa - 24 civile ndërsa 10 penale;
- Prizren – 5 kërkesa, të gjitha penale;
- Mitrovicë – 21 kërkesa: 19 penale dhe 2 civile;
- Gjiilan – 4 kërkesa, prej të cilave 3 civile ndërsa 1 penale;
- Gjykata Supreme – 3 kërkesa, të gjitha penale: e para dhe e treta janë pranuar dhe e dyta është refuzuar. Kërkesa e parë është bërë nga Prokurori i EULEX-it, e dyta nga avokati mbrojtës i të pandehurit dhe e treta nga i pandehuri.

Të 53 kërkesat për marrjen e lëndëve penale kanë përfshirë një spektër të gjerë të parashtruesve të kërkesave, të paraparë në dispozitat e sipërpërmendura të nenit 3 të *Ligjit mbi kompetencat*:

- Prokurorët e EULEX-it kanë bërë 25 kërkesa;
- Kryetari i kolegjit ose kryetari i gjykatës përkatëse – 10 kërkesa;
- Të pandehurit – 4 kërkesa;
- Avokati mbrojtës i të pandehurve – 7 kërkesa;
- Pala e dëmtuar ose avokati mbrojtës i palës së dëmtuar – 7 kërkesa.

Prej 53 kërkesave për marrjen e lëndëve penale, 38 sosh janë pranuar, 10 janë refuzuar ndërsa 5 janë hedhur poshtë.

Siç është dëshmuar më lartë, një numër i madh i lëndëve penale është pranuar në Mitrovicë (nga 21 kërkesat, 19 ishin penale, 17 prej të cilave ishin miratuar). Ky numër i madh i kërkesave, të bëra kryesisht nga Prokurorët e EULEX-it në Mitrovicë, shpjegohet me natyrën komplekse të gjendjes politike dhe të drejtësisë në atë rajon, si dhe me procesin e vazhdueshëm të kthimit të funksionimit efektiv të GjQ të Mitrovicës. Me qëllim të parandalimit të vonesës së mëtejshme në procedurën penale, Prokurorët e EULEX-it kërkojnë marrjen e lëndëve penale dhe caktimin e tyre te gjyqtarët e EULEX-it.

### **Arsyet për pranimin e lëndëve penale**

Arsyet kryesore të dhëna në vendimet e Kryetares së Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it kanë qenë natyra komplekse e lëndëve dhe procedurat padrejtësisht të zgjatura penale. Në disa raste, gjyqësori vendor nuk kishte vullnet ta gjykonte lëndën për shkak të pozitës me ndikim të të pandehurit në qeverinë e Kosovës.

Ka qenë gjithashtu një lëndë në të cilën të pandehurit ishin ish-pjesëtarë të UÇK-së dhe Kryetari i kolegjit ishte kërcënuar. Disa nga lëndët ishin të ndjeshme nga aspekti etnik dhe ishin marrë duke u mbështetur në nenin 3.4 të *Ligjit mbi kompetencat*.

Po ashtu vlen të përmendet se nga lëndët që u kërkuan të merren nga gjyqtarët e EULEX-it, ishin 3 lëndë – 1 në GjQ-në e Pejës dhe 2 në GjQ-në e Prishtinës, në të cilat kërkesa e avokatit mbrojtës të të pandehurve ishte mbështetur në faktin se lënda ishte dërguar për rigjykim tek i njëjti kryetar i kolegjit i cili kishte zhvilluar rigjykimin. Vërtet, KPPK-ja nuk parashih përjashtimin e kryetarit të kolegjit nga rigjykimi. Përkundër kësaj, pasja e gjyqtarit që ka qenë kryetar kolegji dhe tashmë ka formuar mendimin e tij meritore mbi lëndën dhe përsëri kryeson kolegjin me rastin e rigjyimit të lëndës së njëjtë, është konsideruar shkelje e nenit 6 të KEDNj-së. Për këtë qëllim, Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it ka vendosur që në këto dy lëndë të caktojë gjyqtarët e EULEX-it, ndërsa në lëndën e tretë i është rekomanduar Kryetarit të Gjykatës përkatëse të Qarkut që ta ndërrojë kryetarin e kolegjit gjatë rigjyimit. Kështu, si reagim ndaj këtyre tri kërkesave, është bërë një ndryshim në praktikën gjyqësore kosovare në të njëjtën frymë me standardet dhe praktikatat më të mira evropiane.

Në një lëndë tjetër në të cilën është kërkuar marrja përsipër, i pandehuri ishte një zyrtar i gradës së lartë në Shërbimin Policorë të Kosovës i akuzuar për vepër penale të abuzimit seksual të vartëseve. Në procedurën penale para gjyqtarëve vendorë, aty kishte shkelje të drejtave të viktimave, kërkesa e të cilëve për seancë të mbyllur për konfirmimin e aktakuzës nuk i është lejuar duke shkaktuar tek ta parehati dhe shqetësim të madh. Marrja përsipër e kësaj lënde ishte gjithashtu e bazuar në gjetjet e monitorimit të gjyqtarëve të EULEX e cila ka zbuluar nevojën e përmirësimit të kapacitetit të gjyqësorit vendor për ndalimin e veprave penale e njëkohësisht duke pasur respekt të plotë për të drejtat e viktimave.

### ***Bazat për refuzimin e marrjes përsipër të lëndëve penale dhe hedhja poshtë e lëndës***

Siç është përmendur në statistikat e dhëna më herët, 10 nga 48 kërkesa të lidhura me lëndët penale janë refuzuar. Refuzimi është bazuar në faktin se në shumicën e këtyre rasteve procedura penale ka arritur fazën e avancuar ku të gjitha dëshmitë tanimë janë grumbulluar, dhe palët nuk mund ti përkrahin kërkesat e tyre me argumentet e parashikuara në Ligjin mbi Kompetencat (LmK). Në kushte të tilla, inicimi i procedurës së marrjes përsipër do të mund të shkaktonte vetëm vonesë të mëtutjeshme të paarsyeshme. Kërkesat gjithashtu janë hedhur poshtë si të pabazuar pasi që ato nuk e kanë vërtetuar se në këto lëndë ishte “nevoja për të siguruar administrimin e duhur të gjyqësisë”<sup>17</sup> dhe nuk ka siguruar (ofruar) arsye për të besuar se atje mund të kishte dështim të drejtësisë nëse lënda do të mbetej nën përgjegjësinë e gjyqtarëve kosovarë, siç kërkohet nga Neni 3.5 të LmK-së.

Një kërkesë e tillë ishte bërë në lidhje me lëndën penale e cila ishte e pazgjodhur (në pritje) para Gjykatës Komonale të Pejës. Pala e dëmtuar shpjegoi se Gjykata Komonale e Pejës e ka dënuar të akuzuarin për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor dhe ky aktgjykim më vonë është konfirmuar prej Gjykatës së Qarkut në Pejë. Megjithatë, rishikimi i procedurës penale e ktheu lëndën prapa në rivendosje. Pala e dëmtuar nuk besoi në paanshmërinë e gjykatës dhe pohonte se ri-gjykimi ishte shkak i dhënies së mitos dhe ose ndërhyrjes. Ai pretendonte se kushtet ligjore për rishikimin e procedurës penale nuk ekzistonin.

17 Neni 3.5, *Ligji mbi Kompetencat*



## **Vlerësimi i pajtueshmërisë së kërkesës me kërkesat e Neni 3 të Ligjit mbi Kompetencat:**

- Neni 3.3: krimi i shkaktimit të lëndimit të rëndë trupor nuk është futur në listë si krim sipas këtij Neni;
- Neni 3.4: nuk ka dëshmi për historikun diskriminues të lëndës;
- Neni 3.5: për nevojën e sigurimit të administrimit të duhur të drejtësisë sipas

Neni 3.5 të LmK-së, ankuesi nuk specifikoi asnjë kërcënim të bërë ndaj gjyqtarit Kosovar, dëshmitarëve apo palëve në procedurë që do të shpinin në besimin se dështim serioz i drejtësisë do të rezultonte nëse lënda do të mbahej në përgjegjësinë ekskluzive të gjyqtarit Kosovar (Neni 3.5. a), ose që ankuesi të ketë shpjeguar ndërlikimin e veçantë apo natyrën e lëndës duke garantuar aktivitetin e gjyqtarit të EULEX-it me qëllim të shmangies së dështimit të drejtësisë (Neni 3.5. b). Pohimet e paraqitura nga avokati mbrojtës referuan vetëm në besimet që vendimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë të dërgoj lëndën për rigjykim nuk ishte objektiv dhe se nuk ishin plotësuar kushtet për rishikim. Megjithatë, nuk ka asnjë argument ligjor që do të provonte këtë pohime (pretendime).

Bazuar në vlerësimin e mësipërm, është përfunduar se nuk ka baza ligjore për marrjen përsipër të lëndës sipas LmK-së prandaj edhe kërkesa e palës së dëmtuar është refuzuar.

## **c) Përmbledhjet e lëndëve penale që janë marr përsipër nga gjyqtarët e EULEX-it**

Më poshtë janë përmbledhjet e disa lëndëve penale të cilat janë marr përsipër nga gjyqtarët e EULEX-it që ka vazhduar me seancat e marrjes përsipër dhe bazuar në vendimin e Kryetares së Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it.

### **Gjykata Komunale e Mitrovicës**

Me 14 tetor 2009, Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it ka mbajtur gjashtë seanca të marrjes përsipër të lëndëve në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës. Më poshtë është përmbledhur njëra prej lëndëve e cila është dëgjuar në atë datë dhe është marrë përsipër nga Gjyqtarët e EULEX-it.

*Faktet e lëndës:* Në pasditen e datës 30.12.2008, dy meshkuj shqiptarë kosovarë vendosën në mënyrë spontane të shkojnë në Mitrovicën Veriore në këmbë përtej urës kryesore. Një grup i meshkujve serbë kosovarë i përcjellën dhe i sulmuan ata. Grupi filloi ti grushtoj dhe shqelmoj ata. Një dëshmitarë dëgjoi grupin duke bërtitur "Ata janë shqiptarë!". Një prej meshkujve shqiptarë kosovarë (i pandehuri) e nxori thikën dhe mund të ketë goditur me thikë një prej sulmuesve. Atëherë ata ishin në gjendje të largohen prej grupit, por pasi që ata ishin duke ikur në drejtim të Mitrovicës jugore, i pandehuri e goditi me thikë një kalimtar rasti, mashkull serb kosovar, 15 vjeçar, i cili pësoi lëndim të lehtë. Nuk është bërë asnjë identifikim apo arrestim të cilitdo prej grupit të meshkujve serb kosovar;

*Akuzat: Lëndim i Lehtë Trupor;*

*Faza e procedurës penale:* Prokurori i EULEX-it e ka marr përsipër lëndën dhe ka paraqitur propozim akuzën në Gjykatën Komunale të Mitrovicës. I dyshuari ishte i lirë.

*Bazat për marrjen përsipër të lëndës:* Kjo është një lëndë etnikisht e ndjeshme. Edhe pse goditja me

thikë e mashkullit serb kosovar nuk ka qenë etnikisht e motivuar, dukej se sulmi fillestar apo përleshja ishte e motivuar. Për shkak të historisë së sulmeve ndëretnike përtej urës dhe të rrethanave specifike të kësaj lënde, ekziston rreziku që gjyqtarët vendor mos të mbesin të paanshëm. Kjo është dëshmuar nga këndvështrimet e kundërta të zyrtarëve të PK-së në vendngjarje. Mund të jetë e udhës për gjyqtarët e EULEX-it që ta marrin përsipër këtë lëndë me qëllim të sigurimit të një kolegjit të paanshëm dhe të shmangies së keqpërdorimit të Drejtësisë.

Me 18 nëntor 2009, Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it ka mbajtur edhe shtatë seanca tjera të marrjes përsipër të lëndëve në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë. Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it ka vendosur që, sa i përket të gjitha shtatë lëndëve, ti caktojë këto lëndë gjyqtarëve të EULEX-it në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë. Lëndët kishin të bëjnë me 14 të pandehurit prej etnive të ndryshme (Shqiptarë, Serb dhe Romë), dhe një varg i akuzave duke përfshirë *inter alia* vrasje e rëndë, vrasje, tentim vrasje, pronësia, kontrolli, posedimi dhe shfrytëzimi i paautorizuar i armëve dhe dhunimi. Disa prej këtyre lëndëve janë përmbledhur si në vijim.

### **Lënda 1**

*Faktet e lëndës:* Tre të pandehurit (shqiptarë kosovarë), viktima dhe pala e dëmtuar ishin farefis dhe veprat penale ishin kryer si rezultat i konfliktit të ngushtë familjar.

#### **Akuzat:**

- I pandehuri 1: Vrasje e rëndë dhe vrasje e rëndë në tentativë
- I pandehuri 2: Nxitje për kryerjen e vrasjes së rëndë dhe  
Nxitje për kryerjen e tentim vrasjes së rëndë
- I pandehuri 3: Pronësia e paautorizuar, posedimi dhe shfrytëzimi i armëve

*Faza e procedurës penale:* Aktakuza e paraqitur por nuk është konfirmuar. Një prej të pandehurve ishte në paraburgim dhe tjetri në arrest shtëpiak.

### **Lënda 2**

*Faktet e lëndës:* I pandehuri (rom) ka hyrë në shtëpi të palës së dëmtuar, dhe duke përdorur forcën, ka dhunuar dhe kërcënuar atë. Ai e ka ditur që pala e dëmtuar ishte me të meta mentale;

#### **Akuzat:** Dhunim

*Faza e procedurës penale:* Aktakuza e paraqitur por nuk është konfirmuar.

### **Lënda 3**

*Faktet e lëndës:* Lënda përfshin tre të pandehur shqiptar kosovar. Ka pasur shkëmbim të zjarrit në mes të

pandehurit të parë e të dytë dhe viktimës e cila rezultoi në vdekjen e viktimës dhe lëndimeve trupore të të pandehurit të parë dhe të dytë. I pandehuri i tretë erdhi me viktimën duke e ditur se viktima barte armë dhe i ndihmoi gjatë tërë kohës viktimës të kryej veprën penale të vrasjes në tentativë.

#### **Akuzat:**

Të pandehurit 1 dhe 2: Vrasje dhe pronësia, kontrolli, posedimi dhe shfrytëzimi i paautorizuar i armëve;

I pandehuri 3: Vrasje në tentativë;

*Faza e procedurës penale:* Aktakuza është paraqitur por nuk është konfirmuar. I pandehuri i parë ishte në paraburgim, i dyti ishte në paraburgim e më vonë i transferuar në arrest shtëpiak; i pandehuri i tretë kurrë nuk ka qenë në paraburgim.

Në të gjitha lëndët e lartpërmendura të marra përsipër nga EULEX-i në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, procedurat penale ishin në fazën e procedurës paraprake, në të cilën aktakuza kundër të pandehurve ishte paraqitur mirëpo ende nuk ishte konfirmuar. Lëndët përfshinin të pandehurit prej të gjitha grupeve etnike dhe një shumëllojshmëri të veprave penale dhe të akuzave përkatëse penale. Të gjitha lëndët fillimisht janë marr përsipër nga Prokurori i EULEX-it i cili përfundimisht e bëri kërkesën për caktimin e Gjyqtarit të EULEX në lëndë. Megjithatë, siç është parashikuar në Ligjin mbi Kompetencat, kërkesa për marrjen përsipër të lëndës mundet gjithashtu të bëhet prej kryetarit të gjykatës kompetente. Një shembull i tillë është dhënë më poshtë lidhur me lëndën e cila i është caktuar Gjyqtarëve të EULEX-it në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

## **Gjykata e Qarkut në Prishtinë**

Kërkesa për marrjen përsipër lëndën penale të *Agron Haradinaj et alia* e cila ishte në pritje (e pazgjedhur) në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë ishte bërë prej Kryetarit të kësaj Gjykate të Qarkut. Të pandehurit në këtë lëndë akuzoheshin për vepër penale të vrasjes së rëndë në tentativë.

Në deklaratën e tij me shkrim Kryetari i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë ka përkrahur kërkesën e Kryetarit në këtë rast gjyqtarit kosovar për marrjen përsipër të lëndën në kompetencë të gjyqtarëve të EULEX-it për shkak të kërcënimeve që ka marrë nga i pandehuri. Kishte gjithashtu letra nga avokati mbrojtës duke nxitur që gjykimi të caktohet sa më parë.

### **Vlerësimi i përputhshmërisë së kërkesës me kushtet e Nenit 3 të Ligjit mbi Kompetencat:**

Është konstatuar se në këtë lëndë nevojitej “të sigurohet administrimi i duhur i drejtësisë”<sup>18</sup> i përcaktuar nga faktorët vijues: lënda ka qenë e zgjatur për një kohë në fazën e shqyrtimit gjyqësor, prandaj ri-hapja e shqyrtimit kryesor ishte e domosdoshme; Kryetari kosovar i kolegjit ka pranuar kërcënime serioze nga i pandehuri; të pandehurit ishin ish pjesëtarë të UÇK-së të cilët e bënë lëndën politikisht të ndjeshme; të pandehurit ishin në paraburgim për më tepër se dy vite. Bazuar në këto baza të shumfishta është vendosur nga Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it me qëllim të sigurimit të administrimit të duhur të drejtësisë, lënda duhej ti dorëzohet Gjyqtarëve të EULEX-it. Pjesa 3 e këtij kapitulli përmban përmbledhjen e procedurës penale para Gjyqtarëve të EULEX-it.

18 Neni 3.3 në lidhje me nenin 3.5, Ligji mbi Kompetencat



Të gjitha lëndët në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës, dhe lënda në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë për të cilat ishin bërë kërkesat për marrjen përsipër të lëndëve dhe i janë caktuar Gjyqtarëve të EULEX-it. Megjithatë, në disa prej lëndëve, nuk kishte baza të mjaftueshme për caktimin e Gjyqtarëve të EULEX-it sipas Ligjit mbi Kompetencat prandaj kërkesat janë refuzuar. Një shembull i një lënde të tillë është dhënë më poshtë.

#### **d) Kërkesat për marrjen përsipër të lëndëve civile – statistikat dhe analizat specifike**

Prej 34 kërkesave të lidhura me lëndët civile 2 ishin në fazën e përmbartimit. 11 prej 34 kërkesave ishin bërë nga gjyqtari civil i EULEX-it; 2 – nga avokatët mbrojtës të paditësve; 12 kërkesa ishin bërë nga paditësit; 2 nga të paditurit dhe 7 kërkesa janë bërë ose nga kryetari i kolegjit apo nga kryetari i gjykatës përkatëse.

Numri më i madh i kërkesave (25) erdhi prej regjionit të **Pejës**:

20 kërkesa janë pranuar dhe 4 janë hedhur poshtë, 1 kërkesë është në pritje të seancës.

11 kërkesa janë bërë nga Gjyqtari civil i EULEX-it

2 janë bërë nga Kryetari i njërës nga Gjykatat Komunale

10 kërkesa janë bërë nga paditësi

1 kërkesë nga kreditori

Gjatë vitit 2009 nuk ka pasur kërkesa të paraqitur prej regjionit të **Prizrenit**.

Prej 6 kërkesave në **Prishtinë** 2 janë pranuar dhe 1 është refuzuar, 3 të tjera janë në pritje të shqyrtimit.

2 kërkesa të paraqitura në **Mitrovicë** janë në pritje të shqyrtimit dhe deri më tani nuk ka pasur lëndë civile të paraqitura në këtë regjion.

Në **Gjilan** 3 kërkesa janë paraqitur – 2 janë pranuar (lënda e njëjtë në procedurë civile përmbartimore dhe kontestimore në nivel të gjykatës komunale) dhe 1 është refuzuar.

Në përgjithësi, në mbarë Kosovën, 22 kërkesa të lidhura me lëndët civile janë pranuar; 2 janë refuzuar dhe 4 janë hedhur poshtë; përderisa 6 të tjera janë në pritje të shqyrtimit.

Lëndët civile të marra përsipër nga gjyqtarët e EULEX-it ishin lëndë të lidhura me pronën të lidhura me elementin ndëretnik. Këto lëndë janë zgjatur paarsyeshëm dhe pafundësisht, e që ishte tregues i qartë për mosdashjen e gjyqësorit vendor që të merret me to. Në mes të kërkesave të lëndëve civile që të merren përsipër lëndët ishin lëndë që përfshinin pretendimet e shitblerjes mashtruese të pronës; dhe lëndët në të cilat pohuar që gjyqtarët kanë pasur përvojën e presionit prej zyrtarëve të lartë të cilët kërkonin të ndikojnë në rezultatin e lëndës. Ka pasur lëndë në të cilën një prej palëve ka qenë Komuna kështu duke qenë tregues i qartë i rrezikut që gjyqësori vendor të jetë i ndikuar në procedurë.

### **3.Gjykimi i lëndëve penale gjatë ushtrimit të kompetencës primare/ ekskluzive dhe sekondare/subsidiare të gjyqtarëve të EULEX-it**

Kjo pjesë e raportit ofron shembuj të lëndëve penale të hetuara dhe të përndjekura nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK-ja) prandaj edhe bien brenda kompetencave primare të Gjyqtarëve të

EULEX-it. Për më tepër, kjo pjesë paraqet lëndët penale të cilat Gjyqtarët e EULEX-it i gjykuan në ushtrimin e kompetencave të tyre sekondare.

Këto lëndë janë interesante nga perspektiva faktike dhe juridike. Njëra nga lëndët (*Selman Bogiqi et alia*) ka të përfshirë si të pandehur një gjyqtar Kosovar dhe dy zyrtarë tjerë të gjykatës. Raporti gjithashtu ofron përmbledhjen e lëndës së parë penale ndër-etnike të gjykuar nga gjyqtarët e EULEX-it në GjQ të Mitrovicës.

## Gjykata e Qarkut në Prishtinë

***Agron Haradinaj et alia*** (kompetenca sekondare/subsidiare)

Kjo lëndë penale përfshiu katër shqiptarë kosovar të akuzuar për veprë penale të vrasjes së rëndë në tentativë. Siç u përshkrua më lart, gjykimi fillimisht kishte të bëj me kolegjin vendor. Megjithatë, në vijim të kërkesës prej Kryetarit vendor të kolegjit, Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it i caktoi dy Gjyqtarë të EULEX-it në këtë lëndë.

Me 20 nëntor, kolegji i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë i përbërë prej dy Gjyqtarëve të EULEX-it dhe një Gjyqtari kosovar shpalli aktgjykimin dhe i shpalli dy të pandehurit fajtorë për veprën penale të Vrasjes së Rëndë në Tentativë në bashkëkryerje dhe për pronësi, kontroll, posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve. Në lidhje me veprat e njëjta penale i pandehuri i katërt është shpallur i pafajshëm prandaj edhe është liruar. Tre të pandehurit të shpallur fajtor morën dënimet në kohëzgjatje prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) vite, 20 (njëzet) vite, dhe 15 (pesëmbëdhjetë) vite dhe 6 (gjashtë) muaj burgim.

## Gjykata e Qarkut në Prizren

***Selman Bogiqi et alia*** (kompetenca primare/ekskluzive)

Lënda kundër të përfshirëve si paditës gjyqtari kosovar dhe dy zyrtarë tjerë të gjykatës – një prej të pandehurve ishte llogaritar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, i dyti ka punuar në shkrimoren civile në Gjykatën e njëjtë të Qarkut përderisa i treti ishte Gjyqtar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. I pandehuri i parë dhe i dytë kanë qenë të suspenduar dhe i pandehuri i tretë dha dorëheqje.

Të tre të pandehurit ishin të akuzuar me veprën penale të Zbulimit të Fshehtësive Zyrtare në periudhën në mes të 13 gusht 2007 dhe 24 gusht 2007, me 3 shtator 2007 dhe me 7 prill 2008 në komunën e Prishtinës, në kundërshtim me nenin 347 paragrafi 1 të KPPK-së.

Sipas historikut, me 26 korrik 2007, PSRK-ja nxjerri Vendim për fillimin e hetimeve kundër tre të pandehurve për veprat penale të Keqpërdorimit të Pozitës apo Detyrës Zyrtare. Hetimit i është dhënë numri "SEC" sepse të dhënat u vlerësuan të ishin shumë të ndjeshme dhe nuk duhej të zbuloheshin në publik.

Prokuroria pretendon se Selman Bogiqi dhe dy zyrtarë tjerë të gjykatës i kanë informuar të dyshuarit e hetimit të lartpërmendur të filluar me 26 korrik 2007. Ka qenë lëndë e Prokurorisë që informacioni i përfshirë në shkresë që ka qenë i emërtuar si lënda "SEC" ishte Fshehtësi Zyrtare brenda kuptimit të nenit 347 të KPPK-së. Të tre të pandehurit ishin akuzuar me një pikë të akuzës të Zbulimit të Fshehtësive Zyrtare të

kryera në periudhën në mes të 13 dhe 24 gushtit 2007, me 3 shtator 2007 dhe me 7 prill 2008 në komunën e Prishtinës sipas nenit 347 paragrafi 1 të KPPK-së të dënueshme me burgim deri në tri vite.

Pretendimet specifike kundër Gjyqtarit të Gjykatës së Qarkut ishin se në kapacitetin e personit zyrtar duke vepruar si gjyqtar i procedurës paraprake në gjykatën e Prishtinës në hetimin e lartpërmendur penal me qëllim dhe pa autorizim, nëpërmes bisedave telefonike me njërin prej të pandehurve ka komunikuar dhe ia ka dhënë atij në dispozicion informatat e hollësishme lidhur me procedurën hetimore. Kjo informatë përbën Fshehtësi Zyrtare e zbulimi i së cilës ka shkaktuar apo mund të ketë shkaktuar pasoja dëmtuese. Prandaj, i pandehuri ka dëmtuar procedurën penale kundër të pandehurve të akuzuar me marrjen e mitos.

Çështja primare në këtë lëndë ishte nëse lëndët "SEC" ishin "fshehtësi zyrtare" brenda kuptimit të nenit 347 të KPK-së. Informimi apo dokumentimi të përfshihet brenda klasifikimit të "fshehtësisë zyrtare" duhet të shpallet si i tillë me ligj, apo me dispozitë tjetër ose vendim i autoritetit kompetent, i nxjerrë vetë mbi bazat ligjore, për të qenë fshehtësi zyrtare.

Prokurori e pranoi se ai nuk ishte në dijeni të asnjë ligji, apo dispozite tjetër, apo vendimi të autoritetit kompetent, të nxjerrë vetë mbi bazat ligjore që i shpall lëndët "SEC" të ishin fshehtësi zyrtare brenda kuptimit të nenit 347 të KPK-së. Veç kësaj, asnjë dëshmi nuk është ofruar gjykatës që, në kohën kur i pandehuri i parë dhe/ose ai i tretë e zbuluan informatën të kenë formuar qëllimin e marrjes së përfitimit jashtëligjor për veten, person tjetër apo organizatë afariste apo që ata kanë tentuar të shkaktojnë dëm personit tjetër apo organizatës afariste.

Para përfundimit të shqyrtimit kryesor, Prokurori tërhoqi përndjekjen kundër të pandehurit të dytë (nëpunës në Gjykatën e Qarkut ) dhe akuza kundër tij është refuzuar. I pandehuri i parë dhe i tretë janë liruar në pajtim me nenin 390 (1) të KPPK-së. Prokurori i PSRK-së në nivelin e qarkut paraqiti ankesë ndaj këtij aktgjykimi. Kolegji i Gjykatës së Qarkut i përbërë prej gjyqtarëve Kosovarë vërtetoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

## **Gjykata e Qarkut në Mitrovicë**

***Daut Rrahmani*** (kompetenca sekondare/subsidiare)

Lënda kundër Daut Rrahmanit ishte lënda e parë ndëretnike e gjykuar në Gjykatoren e Mitrovicës Veriore. Lënda e cila bie brenda kompetencave të Gjykatës Komunale të Mitrovicës përfshiu të pandehurin shqiptar kosovar; palën e dëmtuar serb kosovar, dëshmitarët serbë dhe shqiptarë kosovar.

I pandehuri shqiptar kosovar Daut Rrahmani ishte akuzuar për pjesëmarrjen në grup të personave që gjoja se kanë sulmuar palët e dëmtuara, dy serb kosovar, me shkopinj të bejsbollit dhe shkopinj të drurit në natën e 04 janarit 2009. Gjatë rrjedhës së procedurës penale, janë dëgjuar pesë dëshmitarë, përfshirë edhe palët e dëmtuara serbë kosovar dhe po ashtu të akuzuarin.

Duke marr parasysh kujdesin e veçantë të situatës politike dhe të sigurisë në veri, është e rëndësishme që lënda e parë ndëretnike të gjykohet nga Gjyqtarët e EULEX-it në gjykatoren e Mitrovicës pa asnjë ndërhyrje të jashtme dhe përçarje publike në lidhje me gjykimin. Procedura u zhvillua qetë dhe u përfundua me 15



maj. Zhvillimi i shpejtë dhe i pakalueshëm i gjykimit gjithashtu ishte i duhur prej faktit se pala e dëmtuar, serb kosovar (sipas iniciativës së tij) e ka dhënë dëshminë e tij në gjuhën shqipe, avokati mbrojtës shqiptar kosovar me miratimin e të mbrojturit të tij ka marr në pyetje dëshmitarët serb kosovar në gjuhën serbe, kështu që koha për përkthim në mënyrë esenciale ishte reduktuar.

Me 15 maj 2009, Gjyqtari i EULEX-i i cili kryesoi shqyrtimit gjyqësor në procedurën e shkurtër të Daut Rrahmanit para Gjykatës Komunale të Mitrovicës e shpalli aktgjykimin. Gjykata shpalli se në mbrëmjen e 04 janarit 2009, i pandehuri së bashku me grupin e personave të panjohur sulmoi dy persona të nacionalitetit serb të cilët rrinin në veturë me tabela të regjistrimit të Serbisë to cilët kishin tezgë në qytetin e Mitrovicës.

Sulmuesit kanë goditur viktimat me shkopinj të bejsbollit dhe shufra të drunjta duke u shkaktuar lëndime trupore njërit nga viktimat dhe dëmtime të veturës. Gjykata ka shpallur të pandehurin fajtor për lëndime të lehta trupore (KPPK, Neni 153, paragrafi (1), pika (4) dhe paragrafi (2)) dhe dëmtim të pasurisë së luajtshme (KPPK, Neni 260, paragrafi (2)). Më tej Gjykata konsideron se krimet ishin të motivuara etnikisht. Daut Rrahmani është dënuar me 6 (gjashtë) muaj burgim. Ekzekutimi i dënimit është pezulluar për 2 (dy) vite që do të thotë nëse i pandehuri do të sillej mire gjatë kësaj kohe, nuk do të mbante 6 (gjashtë) muaj burgim. Po që se nuk do të sillej mire atëherë do ti mbante, natyrisht do të bëhej edhe një gjykim për krimin e ri në të cilin dënimi i mëhershëm do të merrej parasysh në përcaktimin e ndëshkimit të ri.

### ***Predrag Djordjevic*** (kompetencë primare/ekskluzive)

Aktgjykimi në gjykimin kundër të pandehurit Predrag Djordjevic, Serb kosovar ishte shpallur në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë nga kolegji i përbërë prej tre Gjyqtarëve të EULEX-it më 19 Nëntor 2009. I pandehuri ishte në paraburgim që nga 14 Qershori 2008.

Sipas Aktakuzës të Prokurorisë Speciale të paraqitur në Shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë më 2 Qershor 2009, i pandehuri ishte i akuzuar me veprat penale si vijojnë: Nxitje të urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar a etnik, në kundërshtim me Nenin 115 paragrafi (3) në lidhje me paragrafin (1) të KPK Kryerja e Veprave Terroriste, në kundërshtim me Nenin 110 paragrafi (2) dhe (1) në lidhje me Nenin 109 paragrafi (1), nën paragrafët 2,7 dhe 10 të KPK; Tentim për Vrasje të Rëndë në kundërshtim me Nenet 146 dhe 147 në lidhje me Nenin 20 të KPK. Akuza për Terrorizëm është tërhequr nga ana e PSRK gjatë procedurës penale.

Pas mbajtjes së 15 shqyrtimeve të hapura, të gjitha në prani të akuzuarit, Avokatit të tij dhe Prokurorit Publik të EULEXIT, gjatë të cilave janë marrë në pyetje 27 dëshmitarë, aktgjykimi është shpallur publikisht më 19 Nëntor 2009. Kolegji e ka shpallur Djordjeviqin fajtor për Nxitje të urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar a etnik, në kundërshtim me Nenin 115 paragrafi (1) të KPK-së për aktin e vënies së flamurit, i cili simbolizon besimin Ortodoks, në maje të kupolave të Xhamisë së Isa Beut në Mitrovicën Jugore më 14 Qershor 2008.

Po ashtu kolegji ka shpallur të pandehurin fajtor për Përpjekje për Vrasje të Rëndë në kundërshtim me Nenin 147 Pika 10 e KPK në lidhje me Nenin 20 Paragrafi (1) i KPK për shkak të veprimeve të tij kundër Enver Pllanës sepse më 14 Qershor 2008, i pandehuri i armatosur me thikë dhe pistoletë, hyn në oborrin

e rrethuar të Stacionit Policor në Mitrovicën Jugore dhe me qëllim të privoj nga jeta viktimën e tij, nga një distance e afërt, ai ka gjuajtur në policin i cili ishte duke kryer detyrën e tij për të mbrojtur rendin ligjor duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore.

Akuza për Kryerje të Veprës Terroriste, në kundërshtim me Nenin 110 Paragrafi (1) dhe (2) të KPK në lidhje me Nenin 109 Paragrafi (1) Pikat 2, 7 dhe 10 të KPK është refuzuar në bazë të Nenit 389 të KPPK.

Për të përcaktuar dënimin e duhur, kolegji ka pasur në konsiderate gjendjen mentale të çekuilibruar, personalitetin psikotik si edhe kapacitetin e kufizuar të të akuzuarit për të marrë vendime sikurse është përshkruar nga psikiatri i Gjykatës. Në suaza të kësaj rrethane të veçantë lehtësuese, është shqiptuar një dënim unik prej gjashtë vite e tre muaj.

\*\*\*

Përfundimi i gjykimeve kundër Daut Rrahmanit dhe Predrag Djordjevic të mbajtura në Gjykatën e Mitrovicës Veriore është një hap tutje në vendosjen e Sundimit të Ligjit dhe ekzekutimin efektiv të Drejtësisë në këtë pjesë të Kosovës.

Siç është demonstruar në këtë kapitull, gjyqtarët e EULEX-it ushtrojnë funksione ekzekutive mbi një varg të madh veprash penale prej krimeve të luftës kundër popullatës civile deri te krimi i organizuar dhe krimet ekonomike e financiare.

Vlen të përmendet se një numër i vendimeve gjyqësore janë përfshirë në Rishikimin i Ligjit (Themis) të gjyqtarëve të EULEX-it të krijuar pak kohë më parë. Ky Rishikim i Ligjit do të shërbejë si bazë e të dhënave të jurisprudencës së gjyqtarëve të EULEX-it me qëllim të sigurimit të udhëzimit ligjor dhe konsistencës në gjyqësorin e Kosovës. Edicioni eksperimental i Rishikimit të Ligjit u prezantua te homologët vendorë në tetor 2009.

#### **4. Gjykimet në lëndët civile – çështjet kryesore dhe statistikat**

Për më tepër, *Ligji mbi Kompetencat*, Gjyqtarëve të EULEX-it u jep të drejtën 'të përzgjedhin dhe marrin përgjegjësitë' për lëndët civile të cilat përfshijnë rastet brenda kompetencave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për çështje që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) që përfshijnë 'ndonjë lëndë civile të re apo të pazgjidhur për pronësinë, duke përfshirë procedurat e ekzekutimit që bien nën kompetencë të secilës gjykatë në Kosovë<sup>19</sup>. Kapitulli pasues ka për qëllim të paraqes një pamje të ushtrimit të kompetencës që u është dhënë Gjyqtarëve të EULEX-it në fushën civile. Kapitulli fokusohet në juridiksionin e Kolegjit të Ankesave të Gjykatës Supreme për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), DhPGJS-në si edhe do të sjellë shembuj të gjykimet të lëndëve civile në Gjykatat Komunale dhe të Qarkut të Kosovës.

##### **Të dhënat statistikore**

Gjatë vitit 2009, numri më i madh i lëndëve civile (21) ishin gjykuar në regjionin e Pejës. Një nga të gjitha këto raste, ishte gjykuar në nivel të Gjykatës së Qarkut me një kolegji të përbërë nga 2 (dy) gjyqtarë të

19 7 Neni. 5.1, *Ligji mbi Kompetencat*

EULEX-it dhe 1 (një) gjyqtar kosovar. Të 20 (njëzet) rastet tjera ishin gjykuar në nivel të Gjykatës Komunale prej një gjyqtari të EULEX-it. Deri në Dhjetor të vitit 2009 janë mbyllur 14 lëndë civile dhe janë lëshuar aktgjykimet. Ndaj të gjitha këtyre janë paraqitur ankesa nga njëra palë dhe tani janë të pazgjdhura në nivel të Gjykatës së Qarkut.

### **Çështjet kryesore – rigjykimet e përsëritura, procedurat e zgjata dhe ekzekutimi i vendimeve**

Gjatë gjykimit të lëndëve civile është identifikuar një varg problemesh në gjykatat e Kosovës. Në veçanti, gjyqtarët e EULEX-it kanë vërejtur se procedura në **kontestet pronësore ndëretnike** zgjatet në mënyrë të paarsyeshme dhe të vazhdueshme. Shumë kërkesa të këtilla janë paraqitur në vitin 2004 në Gjykatat Komunale (GJK) të rajonit të Pejës. Në vitin 2009, gjyqtari civil i EULEX-it në Pejë ka përzgjedhur dhe ka lëshuar aktgjykime në 14 lëndë të kontesteve pronësore ndëretnike duke u bazuar në Nenin 5.1. (c) të *Ligjit mbi kompetencat*. Këto lëndë ishin të ngjashme pasi që të gjitha kishin të bënë me marrëveshje mashtruese, paditësit kishin lënë pasurinë e tyre në Kosovë më 1999 pas bombardimeve të NATO-s dhe kishin ikur jashtë vendit. Në këtë fazë, pronësia e paditësve mbi pronat e pohuara nuk ishte e kontestueshme; këto prona ishin në pronësi të paditësit apo të farefisit të tij të ngushtë. Pas konfliktit paditësit u kthyen në Kosovë por gjetën pronat e tyre të uzurpuara nga të paditurit përkatës, të cilët kishin kontrata mbi transaksionin me paditësit, sipas të cilave ata pretendojnë të drejtën e tyre të posedimit. Paditësit kërkojnë anulimin e këtyre kontratave për transaksionin e pronës, duke pohuar se ata kurrë nuk iu kishin shitur pronat e tyre të paditurve dhe se këto kontrata të transaksionit ishin falsifikuar.

Në disa lëndë paditësit madje kanë pasur edhe vendim të lëshuar nga KKBP – Komisioni për Kërkesa Banesore Pronësore apo nga KKKP – Komisioni Kosovar për Kërkesa Pronësore, në favor të tyre, prandaj të paditurit ishin dëbuar nga pronat e tyre. Përkundër kësaj, regjistrat në kadastër nuk ishin korrigjuar fare, prandaj të paditurit ende figuronin si pronarë të pronës së kontestueshme, kështu që paditësit ishin juridikisht të interesuar që të nisnin procedurat gjyqësore për ta ndryshuar titullin e pronësisë.

Çështja kryesore ligjore e diskutuar në të gjitha lëndët ishte nëse paditësi qëllimisht ia kishte shitur pronën e vet të paditurit apo nëse kjo pronë ishte transferuar në mënyrë të paligjshme pa dijen e tyre duke u shërbyer me dokumente të falsifikuara.

Për të vendosur nëse paditësit kanë dhënë ose jo autorizimin e tyre për shitje me nënshkrimin e këtij autorizimi ligjor të kundërshtuar, gjykata ka vlerësuar këto lloje të dëshmive:

#### **- Analizën e dorëshkrimit**

Gjykata, me propozim të paditësit, ka urdhëruar ekzaminimin mjeko-ligjor të dorëshkrimit / gjurmëve të gishtërinjve në autorizim me qëllim të krahasimit të tyre me mostrat e dorëshkrimit / gjurmëve të gishtërinjve të paditësit. Gjyqtari civil në Pejë në disa raste ka kërkuar nga laboratorit i mjekësisë ligjore i Policisë së Kosovës në Prishtinë për t'i kryer analizat (të cilat në të kaluarën bëheshin vetëm për lëndë penale)<sup>20</sup>.

20 *Shih Gjykata Komunale e Istogut, Milos Nedeljkovic vs. Besim Fetahu & Hekuran Blakaj, C. Nr. 165/06, Aktgjykimi i*



Gjyqtarët e EULEX-it edhe më herët kanë bërë analiza të dorëshkrimit të marrë gjatë procedurës para Komisionit kuazi-gjyqësor për Kërkesa Banesore Pronësore (KKBP). Me përdorimin e teknikave ligjore *kolateral estoppel* apo të pengimit të çështjes, gjykata në disa raste ka vendosur që analiza e kryer në KKBP duhet të jetë e vlefshme edhe në procedurën e transaksionit mashtrues<sup>21</sup>. Kjo teknikë është dëshmuar të jetë shumë efikase për përshpejtimin e procedurës.

### - Certifikata e vdekjes

Në disa raste, paditësi argumentonte se personi i cili ishte në posedim të pronës së kontestuar dhe që dukej se kishte nënshkruar autorizimin ligjor, në të vërtetë kishte qenë tashmë i vdekur në kohën e shitjes së pronës. Për ta vërtetuar këtë, gjykata ka kërkuar certifikatën e vdekjes nga autoritetet përkatëse vendore<sup>22</sup>. Kjo gjë ka pasur sukses në disa raste, megjithatë, për shkak se pas luftës dokumentet e regjistrimit siç janë certifikatat e vdekjes shpesh edhe nuk janë lëshuar në Kosovë, në disa raste dokumentet përkatëse nuk ka pasur mundësi që të zbulohen.

### - Numri Unik Personal i Qytetarit (NUPQ)

Në ish-RSFJ, të gjithë qytetarët kishin një Numër Unik Personal i Qytetarit (NUPQ) që përmbante një kod prej 13 shifrash me datën e lindjes, vendin e lindjes dhe gjininë e personit.

Përmes analizës së letërnjoftimeve të bashkëngjitura në autorizimet e kundërshtuara ligjore, të kontrolluara në bazë të regjistrave zyrtarë, në shumë lëndë është konstatuar se NUPQ e letërnjoftimit të bashkëngjitur në autorizimin e kundërshtuar ligjor nuk është përputhur me të dhënat personale të paditësit<sup>23</sup>. Për shembull, në disa nga letërnjoftimet e paditësve të gjinisë mashkullore të bashkëngjitur në autorizimin e kundërshtuar ligjor, figuronte shifra që korrespondonte me gjininë femërore dhe gjithashtu vendi dhe data e lindjes nuk përputhej me të dhënat personale të paditësit. Në bazë të këtyre informatave, gjykata ia doli të vërtetonte se këto letërnjoftime të bashkëngjitura ishin në fakte dokumente të falsifikuara.

### - Verifikimi në gjykata

Zakonisht, autorizimi i falsifikuar ligjor në këto raste regjistrohej në gjykatë. Megjithatë, në disa raste gjykata ka konstatuar se këto dokumente nuk ishin regjistruar asnjëherë ndërsa vula e gjykatës ishte falsifikuar.

---

datës 15 prill 2009

21 *Shih* Gjykata Komunale e Klinës, *Zivan Mazic vs. Bardhil Azem Marmullaku*, C. Nr. 47/04, Aktgjykimi i datës 7 gusht 2009; dhe *Vladimir Radosavljevic vs. Tahir Morina*, C. Nr. 48/04, Aktgjykimi i datës 7 prill 2009

22 *Shih* Gjykata Komunale e Klinës, *Milorad Mikic vs. Ali Morina*, C. Nr. 302/05, Aktgjykimi i datës 7 gusht 2009

23 *Shih* Gjykata Komunale e Klinës *Rajko Dabizljevic vs. Limon Maloku & Mentor Maloku*, C. Nr. 196/06, Aktgjykimi i datës 22 tetor 2009; *Vlastimir Dabizljevic vs. Lemon Maloku & Mentor Maloku*, C. Nr. 197/06 Aktgjykimi i datës 22 tetor 2009; dhe *Slobodan Dabizljevic vs. Lemon Maloku & Mentor Maloku*, C. Nr. 198/06, Aktgjykimi i datës 22 tetor 2009.

## - Çështjet procedurale

Në disa raste, gjyqtari i EULEX-it ka vërejtur se gjykata vendore kishte pezulluar procedurën për shkak të një lënde në vazhdim e sipër përkitazi me falsifikimin e dokumenteve të kundërshtuara. Kjo gjë ka ngadalësuar lëndët për disa vjet, dhe shpesh pa ndonjë arsye, kështu që aktakuza në fund është refuzuar. Në raste të tilla, gjyqtari i EULEX-it ka marrë përsipër lëndën dhe e ka përfunduar atë pa pritje që lënda penale të mbyllet. Arsyeshmëria e këtij veprimi ishte interesi i paditësit, të cilit në rend të parë duhet që t'i sigurohet kthimi në pronën e vet, gjë e cila nuk mund të realizohet me procedurë penale; edhe po qe se i pandehuri dënohet për një vepër penale, lënda civile prapëseprapë duhet që të kryhet me qëllim të kthimit të pronës së paditësit. Për më tepër, lëndët penale shpesh marrin shumë kohë dhe dështojnë. Për këtë qëllim, pezullimi i lëndës civile derisa të kryhet procedura penale në të shumtën e rasteve nuk i shërben interesit të drejtësisë.

Duke përdorur metodat ligjore të përmendura më lart, gjyqtarët e EULEX-it janë munduar që të zbatojnë metoda të reja për gjyqtarët kosovarë në mënyrë që ata t'i përdorin këto metoda gjatë punës së tyre të përditshme.

Gjatë kryerjes së funksioneve të tyre të MUK-ut, gjyqtarët e EULEX-it po ashtu kanë vënë re një tendencë për **përsëritjen e ri-gjykimeve** në lëndët pronësore, e cila nënkupton se në rast të ndonjë parregullsie në aktgjykim ose në procedurë, gjykata e shkallës së dytë zakonisht kthen lëndën në shkallën e parë në vend që të vendosë mbi meritat e saj. Në vend të kësaj, po qe se gjendja faktike është e paqartë, lënda kthehet për rigjykim në Gjykatën Komunale, që mund të ndodhë disa herë. Palët në kontest po ashtu dëmtohen me këtë gjë, pasi që lënda e tyre shëtit poshtë e lartë disa herë në mes të gjykatave të këtyre dy shkallëve, që rezulton me shpenzime të papranueshme dhe me procedura të zgjatura.

Pas zbulimit të praktikës së rigjykimeve të përsëritura në lëndët që lidhen me pronën, në mars 2009, gjyqtari civil i EULEX-it në Pejë përzgjodhi dhe mori përgjegjësinë për një lëndë në pritje të shkallës së dytë në Gjykatën e Qarkut në Pejë. Lënda kishte të bënte me verifikimin e pronësisë së pronës, ndërsa palët u përkisnin komuniteteve të ndryshme (paditësi ishte shqiptar kosovar, ndërsa katër të paditurit ishin një shqiptar kosovar dhe tre serbë kosovarë). Midis arsyeve të tjera për përzgjedhjen e kësaj lënde ishte edhe dyshimi i bazuar për shkelje të rëndë të ndershmërisë së procedurës si dhe gjasat e mëdha që kjo lëndë do të kthehej përsëri në rigjykim nga kolegji vendor për ankesa. Përmbledhja e kësaj lënde civile të shkallës së dytë është e dhënë më poshtë.

### ***Noz Berisha kundër Milivoje Vuckovic, Martin Krasniqi, Golib Vuckovic dhe Stojan Vuckovic***

Gjykata Komunale e Klinës në aktgjykimin e saj të datës 23 qershor 2008 ka miratuar si të bazuar kërkesën e Noz Berishës kundër të paditurve Martin Krasniqi, Milivoje Vuckovic, Golib Vuckovic dhe Stojan Vuckovic, dhe ka konfirmuar se Noz Berisha, duke u bazuar në kontratën mbi transaksionin të lidhur me Martin

Krasniqin, ka qenë pronar i ngastrës së kontestuar të tokës. Martin Krasniqi ka paraqitur ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë në Gjykatën e Qarkut të Pejës. Kjo ankesë është mbështetur në vërtetimin e gabuar të fakteve dhe në zbatimin e gabuar të ligjit material.

Kolegji i Gjykatës së Qarkut ka qenë i përbërë nga dy gjyqtarë civilë të EULEX-it dhe një gjyqtar civil kosovar; ky ka qenë kolegji i parë i përzier i gjyqtarëve civilë. Gjatë rrjedhës së procedurës është bërë e qartë se kontrata në fakt është lidhur në mes të të paditurve dhe vëllait të paditësit; përderisa vetë paditësi nuk ka qenë kurrë i përfshirë në tërë këtë. Për më tepër, një vëlla tjetër i paditësit ka dëshmuar se në të vërtetë ai është pronari i tanishëm i ngastrës së tokës në fjalë dhe në posedim të saj qe 20 vjet me radhë. Në këtë mënyrë, Gjykata e Qarkut ka konstatuar se paditësi nuk kishte fituar pronësinë dhe rrjedhimisht nuk do të kishte mundësi që të kërkonte pronësinë mbi atë pronë. Lënda është përfunduar brenda një seance, ndërsa aktgjykimi është lëshuar më 18 mars 2009. Ankesa e të paditurit është miratuar, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ndryshuar. Gjykimi i kësaj lënde në shkallën e dytë ka treguar se gjykata e shkallës së dytë është në pozitë që të vendosë lëndën në mënyrë meritorë në vend se ta kthejë të njëjtën për rigjykim në gjykatën komunale.

Gjatë kryerjes së funksioneve të tyre të MUK-ut, gjyqtarët e EULEX-it gjithashtu kanë vërejtur se gjyqtarët vendorë përballen me vështirësi gjatë trajtimit të **ekzekutimit të vendimeve gjyqësore**. Kjo mungesë shpie në rritjen e numrit të lëndëve të pazgjidhura që presin ekzekutimin në gjykatat komunale. Më poshtë është një shembull i një lënde pronësore që pret zgjidhjen në Gjykatën Komunale të Vitisë, e cila është marrë përsipër nga EULEX-i me qëllim të sigurimit të zbatimit të shpejtë dhe efikas të vendimit gjyqësor.

### ***“Drenusha” kundër Komunës së Vitisë***

Në vjeshtën e vitit 2008, Komuna e Vitisë ka uzurpuar objektin i cili ka qenë duke u shfrytëzuar nga shoqata e gjuetarëve “Drenusha”. Më 19 maj 2009, pas kërkesës së bërë nga Kryetarët përkatës së Gjykatës së Qarkut të Gjilanit dhe të Gjykatës Komunale të Vitisë, EULEX-i ka marrë përsipër lëndën, e cila tashmë gjendej në fazën e përmbarrimit, që d.m.th. gjykata tashmë kishte sjellë vendimin e saj. Gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë kanë konstatuar se shoqata e gjuetarëve kishte të drejtën e posedimit të ngastrës dhe të objektit të pretenduar. Kjo lëndë, në të dy shkallët, ishte vendosur nga ana e gjyqtarëve vendorë. Pasi që të gjitha mjetet e mundshme juridike për këtë lëndë tashmë ishin shterur, vendimi i shkallës së dytë ishte i formës së prerë dhe si i tillë duhej që të zbatohet, prandaj ishte caktuar gjyqtari i EULEX-it për procedurën e përmbarrimit. Me qëllim të sigurimit të përmbarrimit të vendimit të gjyqtarëve vendorë, gjyqtari i EULEX-it ka urdhëruar Komunën e Vitisë që ta lirojë objektin dhe të mos pengojë më përdorimin e tij nga ana e shoqatës “Drenusha”.



Në mars 2009, Komuna e Vitisë ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Komunale të Vitisë për njohjen e së drejtës së saj për pronësi të ngastrës së tokës dhe të objektit në fjalë. Përderisa në gjykimin e parë, gjykata kishte shpallur të drejtën e posedimit të kësaj ngastre të tokës dhe të objektit në favor të shoqatës "Drenusha", temë e gjykimit të dytë ishte e drejta e pronësisë të kësaj prone, që nënkupton të drejtën ligjore për kontrollin dhe shfrytëzimin e kësaj prone, e cila nënkupton po ashtu edhe të drejtën për ta poseduar. Nuk është kontestuese ekzistenca e marrëveshjes lidhur me bartjen e pronës në mes të Komunës dhe të shoqatës së gjuetarëve. Megjithatë, natyra e kësaj bartjeje është e kontestuar. Komuna e Vitisë pohon se e drejta mbi shfrytëzimin e pronës tashmë është bartur. Nga ana tjetër, shoqata e gjuetarëve "Drenusha" pretendon se Komuna ka bërë bartjen e së drejtës së pronësisë mbi këtë pronë. Kryetarët e Gjykatës së Qarkut të Gjilanit dhe të Gjykatës Komunale të Vitisë kanë kërkuar që EULEX-i ta marrë këtë lëndë, ndërsa palët kanë shprehur pajtimin e tyre lidhur me këtë kërkesë.

## **V. Kolegji për Ankesa të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës**

Kolegji për Ankesa të AKP-së është pjesë e Gjykatës Supreme të Kosovës. Funkzioni i tij është që të kalojë aktgjykimet e formës së prerë mbi ankesat kundër vendimeve të Komisionit Kosovar për Kërkesa Pronësore (KKKP). Mandati i tij është i kufizuar në ato kërkesa që përfshijnë rrethanat të cilat janë drejtpërsëdrejti të lidhura ose rezultojnë nga konflikti rreth pronësisë dhe të drejtave të shfrytëzimit të pronës në rastet e pasurisë së patundshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, kur pala nuk ka mundur të ushtrojë këto të drejta pronësore. Pjesa më e madhe e paditësve i përkasin komunitetit serb, të cilët kishin ikur nga Kosova për shkak të konfliktit. Këta paditës pohojnë se pronat e tyre janë uzurpuar në mënyrë të paligjshme nga (kryesisht) shqiptarë kosovarë. Prandaj, gjykimi meritor i këtyre rasteve kërkon që të konstatohet vlefshmëria e përvetësimit të të drejtave pronësore të pohuara të paditësit. Kolegji ka tre anëtarë, dy nga të cilët janë gjyqtarë të EULEX-it. Punonjës tjerë janë Shefi i Shkrimores në Asamblenë e Gjyqtarëve të EULEX-it (me orar të shkurtuar) dhe një Zyrtar Ligjor i EULEX-it; postet e një Këshilltari vendor Ligjor dhe të një Asistenti Gjuhësor/Administrativ janë të parapara në planet e zgjerimit.

Deri në përmbylljen e afatit për dorëzim të kërkesave në KKKP, janë regjistruar përafërsisht 40,000 kërkesa. Pjesa më e madhe e këtyre kërkesave (38,000 sosh) janë të pakontestueshme në kuptim të asaj se nuk ka pasur palë të paditur të përfshirë në procedurë. Momentalisht, vlerësohet se prej përafërsisht 2,000 ankesave të kontestueshme, 800-1000 syresh do të ankimohen pranë Kolegjit për Ankesa të AKP-së. Ky numër i vogël i ankesave të kontestueshme të vendosura deri më tani nga KKKP, problemet në kuadër të procedurës së njoftimit lidhur me ankesat e AKP-së dhe vështirësi të ngjashme me disa çështje procedurale në AKP, në masë të madhe e kanë ulur numrin e lëndëve të gatshme për procesin e ankimit. Kjo është arsyeja pse Kolegji për Ankesa të AKP-së, deri më tani, nuk ka pranuar më tepër se 9 ankesa nga KKKP-ja. Për shkak të faktit se faza e parë e procesit të verifikimit të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në tërë Kosovën nuk e përfshinte edhe emërimin e Gjyqtarit vendor të Gjykatës Supreme në Kolegjin e Ankesave të AKP-së, një gjyqtar i tillë nuk është emëruar gjatë vitit 2009. Mungesa e gjyqtarit vendor nënkupton

se juridikisht kolegji nuk është në gjendje që të nxjerrë aktgjykime të formës së prerë. Megjithëkëtë, në shumicën e ankesave të dorëzuara, urdhrat e gjykatës janë të nevojshëm për konstatimin e fakteve dhe/ose për pranimin e të drejtës për t'u dëgjuar. Këta urdhra të gjykatës janë përgatitur nga dy anëtarët ndërkombëtarë të kolegjit në cilësinë e gjyqtarëve raportues. Përveç kësaj, janë marrë edhe masa të tjera të nevojshme për vënien në funksion të Kolegjit për ankesa të AKP-së: Kolegji ka ngritur shkrimoren e vet, ka hartuar procedurat për qarkullimin e lëndëve dhe metodat për shqyrtimin e lëndëve në bashkëpunim të ngushtë me AKP-në, dhe në përgjithësi ka bërë përgatitjet për një proces të menjëhershëm vendimmarrës pas emërimit të anëtarit vendor të Kolegjit. Për shkak të legjislacionit civil të komplikuar dhe ndonjëherë të paqartë, detyra e lokalizimit dhe e përpilimit të ligjeve të nevojshme për kompetencat e këtij Kolegji, po ashtu i ka preokupuar në masë të konsiderueshme anëtarët e tij gjatë gjithë vitit 2009.

Në vitin 2009, aktivitetet tjera të anëtarëve të Kolegjit për Ankesa të AKP-së ishin shqyrtimi i ankesave të paraqitura nga individë në Kosovë mbi çështje të ndryshme civile si dhe përcjellja e tyre te anëtarët e kolegjit nga ana e Zyrës së Kryesisë së Gjyqtarëve të EULEX-it. Numri i këtyre ankesave arrinte në gjithsej 35 dhe të gjitha në përjashtim të dy syresh ishin kryer gjatë vitit 2009. Gjithashtu, anëtarët e Kolegjit kanë marrë pjesë edhe në sistemin e kujdestarisë të Gjykatës Supreme (duke filluar nga pranvera 2009) si dhe në grupe punuese dhe seminare të ndryshme. Ata organizuan një kurs trajnimi mbi çështjet pronësore për gjyqtarët civilë të EULEX-it. Vlerësime të ndryshme ligjore si dhe propozim-vendime janë dorëzuar te Shefi i Komponentit të Drejtësisë së EULEX-it, te Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it dhe te Asambleja e Gjyqtarëve të EULEX-it. Në një sërë takimesh, janë vendosur dhe janë vazhduar kontakte qoftë me homologët ndërkombëtarë qoftë me ata vendorë me qëllim të shkëmbimit të informatave dhe të kanalizimit të përpjekjeve.

Të dy Gjyqtarët e EULEX-it në Kolegjin për Ankesa të AKP janë: Anëtarë të paneleve përzgjedhëse për gjyqtarë dhe punonjës të ri ligjorë të EULEX-it, anëtarë rezervë të Panelit të Misionit të EULEX-it në Kosovë për Rishikimin e të Drejtave të Njeriut, si dhe Gjyqtarë të EULEX-it në Gjykatën Supreme për lëndë të përgjithshme civile e gjithashtu edhe anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe Komitetit përkatës për çështje disiplinore gjyqësore.

## **VI. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me AKM-në**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme (DhPGJS) të Kosovës për çështje që lidhen me AKM-në është themeluar nga UNMIK-u në vitin 2003 si gjykatë ndërkombëtare për sigurimin e një mekanizmi të fuqishëm dhe të paanshëm kontrolli për procesin e privatizimit në Kosovë të kryer nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM). Në fillim të vitit 2009, është ristrukturuar dhe është zgjeruar, duke përfshirë një numër prej gjithsej 43 gjyqtarësh të EULEX-it dhe punonjës të tjerë ndërkombëtarë dhe vendorë. Kryetari i DhPGJS-së është emëruar më 28 janar 2009.

Dobësitë e vazhdueshme të gjyqësorit vendor, e në veçanti paaftësia e tij për të trajtuar siç duhet lëndët kontestuese e të tilla janë shumica e lëndëve të cilat bien në fushën e kompetencave të DhPGjS-së si edhe probabiliteti i lartë i përfshirjes së krimit të organizuar në çështjet që lidhen me privatizimin, të shoqëruara shpesh edhe me ushtrimin e presionit mbi gjyqtarët vendorë, e bën të domosdoshme praninë e vazhdueshme ndërkombëtare në këtë fushë të zbatimit të drejtësisë në Kosovë.

## **Baza ligjore e DhPGjS-së, mandati ekzekutiv**

Baza ligjore për themelimin e DhPGjS-së në formën e tanishme është Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2008/4 dhe Urdhëresa Administrative i UNMIK-ut nr. 2008/6. Gjyqtarët e EULEX-it në DhPGjS kanë vetëm funksione ekzekutive; ata nuk angazhohen në aktivitete të MUK-ut. Ligji përcakton kolegje të përziera në të dy shkallët, me gjyqtarët e EULEX-it si shumicë në kolegje.

## **Trashëgimia e UNMIK-ut**

Dorëzimi i 597 shkresave të lëndëve ("lëndët e trashëguara nga UNMIK-u") nga ana e DhPGjS-së "vjetër" është bërë në përputhje me Marrëveshjen mbi transferimin e shkresave të lëndëve të gjyqtarëve, të arritur në mes të UNMIK-ut dhe EULEX-it më 9 dhjetor 2008. Në atë datë ishin pezulluar pothuaj të gjitha lëndët e DhPGjS-së së "vjetër" nga data 29 korrik 2008, pas Vendimit ekzekutiv të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), nr. 2008/34.

DhPGjS-ja e "re" është bërë funksionale në fillim të vitit 2009. Më 13 shkurt 2009, DhPGjS-ja filloi ta heq pezullimin e lëndëve në mënyrë individuale. Që nga fillimi, DhPGjS-ja ka bërë të gjitha përpjekjet për arritjen e standardeve dhe të praktikave më të mira evropiane lidhur me menaxhimin e gjykatës. Pikat e para në rendin e ditës kanë qenë zhvillimi dhe implementimi i një sistemi modern për përbërjen e trupit gjykues në shkallën e parë dhe të dytë, një sistem i paracaktuar për caktimin e lëndëve me rrotacion në mesin e gjyqtarëve, duke siguruar transparencë dhe ndarje të drejtë të ngarkesës së punës, duke ruajtur nga ana tjetër një dozë fleksibiliteti për shkak të hyrjes dhe daljes së rregullt të gjyqtarëve në kuptim të fillimit dhe mbarimit të mandatit të tyre në kuadër të misionit të EULEX-it. Parime të njëjta janë zbatuar edhe në sistemin përkatës për caktimin e lëndëve në mes të zyrtarëve ligjorë ndërkombëtarë dhe këshilltarëve ligjorë vendorë.

Përveç kësaj, DhPGjS-ja ka zbatuar edhe rregulla të tjera për organizimin dhe mbarëvajtjen e punëve brenda DhPGjS-së, për trajtimin dhe përcjelljen e shkresave të lëndëve, për integrimin e një ekipi të përthyesve me normë të kërkuar prej mbi 1,000 faqesh në muaj, për rregullat e procedurës para DhPGjS-së, për përgatitjen dhe mbajtjen e këshillimeve dhe shqyrtimeve, për formatin dhe faqosjen e njësuar të vendimeve, për rregullat për qasjen e publikut në shkresat e lëndës dhe për publikimin e vendimeve.



Është futur në përdorim dhe është përmirësuar vazhdimisht sistemi elektronik për caktimin automatik të lëndëve në përputhje me rregullat, për regjistrimin e të dhënave përkatëse si dhe një sistem që bazohet në fjalën kyçe dhe që shërben për mbajtjen e të dhënave mbi vendimet e gjykatës.

Përveç kësaj, DhPGjS-ja ka filluar të zbatojë një procedurë efektive përmes të cilës palët mund të aplikojnë për t'u liruar nga pagesa e shpenzimeve të gjykatës dhe/ose për ndihmë në përkthimin e dokumenteve në gjuhën angleze, gjuhë kjo e DhPGjS-së. Për këtë qëllim, DhPGjS-ja përdor formularin e aplikacionit i cili është në dispozicion në gjuhën angleze, serbe dhe shqipe në formë të kopjes fizike dhe të shkarkuar në formë elektronike. Deri më tash DhPGjS-ja ka pranuar 92 aplikacione të tilla.

Gjatë periudhës raportuese, DhPGjS-ja ka sjellë 668 vendime procedurale për lejueshmërinë dhe ka lëshuar 29 aktgjykime për vitin 2009. Prej fillimit deri më tani, janë vendosur 313 lëndë të pranuar nga UNMIK-u. Palëve u janë lëshuar 964 urdhra, duke pasqyruar faktin se një pjesë e madhe e kërkesave të dorëzuara në DhPGjS janë të një standardi të dobët, dhe shpesh kërkesa të tilla nuk përmbushin kriteret për të qenë të pranueshme, të përcaktuara me ligjin në fuqi. Numri i madh i vendimeve procedurale dhe urdhrat për sqarim pasqyrojnë njohuri të pamjaftueshme të rregullave bazike procedurale nga ana e palëve, dhe shpesh ndodh që madje as avokatët të mos dinë sa duhet për legjislacionin në fuqi të UNMIK-ut. Në shumicën dërmuese të lëndëve, DhPGjS-ja duhet që të ofrojë udhëzime lidhur me çështjet procedurale duke lëshuar urdhra për sqarim të kriterëve të pranueshmërisë. Për këtë arsye, procedura me shkrim zakonisht merr shumë kohë dhe angazhon burime të konsiderueshme. Nga ana tjetër, një gjë e tillë duhet të konsiderohet si një formë e ngritjes të kapaciteteve për gjyqësorin vendor.

## **Pengesat**

Që nga fillimi, DhPGjS-ja është përballur me pengesa të konsiderueshme derisa ka arritur shkallën e plotë të funksionimit: mungesa e gjyqtarëve ndërkombëtarë dhe vendorë, situata e paqartë politike në Kosovë, natyra komplekse e kornizës ligjore, burimet e pamjaftueshme (mungesa e hapësirës së mirëfilltë për akomodimin e të gjithë personelit, kufizimet buxhetore, infrastruktura e dobët), dhe praktikrat e papërshtatshme të cilat duhej të ndaleshin (si p.sh. takimi i palëve me gjyqtarët lidhur me lëndët e tyre, refuzimi i pranimit të disa lëndëve në shkrimore, caktimi arbitrar i lëndëve, fshehtësia e pamjaftueshme e mbajtjes së këshillimeve).

## **Lëndët mbi listat e punëtorëve**

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) i ka dorëzuar DhPGjS-së 24 "lista të punëtorëve (lista të punëtorëve me të drejtë të pjesëmarrjes në të ardhurat nga privatizimi), të cilat në shumë raste kanë pasur defekte të rënda dhe nuk kanë qenë në përputhje me ligjin. Përkundër kësaj, AKP-ja vazhdimisht ka fajësuar DhPGjS-në duke thënë se ajo është përgjegjëse për gjendjen e krijuar, prandaj edhe protestat e punëtorëve deri më tash janë mbajtur para objekteve të DhPGjS-së. Janë paralajmëruar protesta të reja duke rritur kështu edhe më tej presionin tashmë të shkaktuar nga protestat e gjertanishme.

Pas vendimit të AKP-së për ndarjen e përkohshme të një pjese të të ardhurave, derisa DhPGjS-ja të merr vendimin e formës së prerë, situata është qetësuar.

Sipas Nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/45, punëtorët e ndërmarrjes e cila i nënshtrohet privatizimit gëzojnë të drejtën për hisen e tyre prej 20% në të ardhurat nga privatizimi dhe likuidimi. Lista e punëtorëve të kualifikuar caktohet nga organi përfaqësues i punëtorëve në bashkëpunim me Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) dhe të shqyrtuar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM). Pasi që AKM-ja ka pushuar funksionet e saj në vitin 2008, këto lista publikohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP). Lista përfundimtare e publikuar nga AKP-ja mund të kundërshtohet para DhPGJS-së.

Gjatë periudhës 1 mars 2010 deri më 31 maj 2010, DhPGJS-ja ka ftuar të gjithë parashtruesit, afërsisht 1,400 syresh në lëndën e NPSH "Ramiz Sadiku", dhe është duke mbajtur shqyrtime për 32 ditë të plota në mënyrë që t'i japë çdo parashtruesi mundësinë e paraqitjes së lëndës të tij para gjykatës. Një gjë e tillë kërkon burime të konsiderueshme, të cilat do t'i përkushtohen shqyrtimit të kësaj lënde.

Edhe pse është duke u përballur me shumë probleme të natyrës ligjore, politike dhe administrative, që nga fillimi i vitit 2009, DhPGJS-ja ka bërë përparime të ndjeshme në sjelljen e praktikave të kësaj gjykate në një nivel me standardet dhe praktikat më të mira evropiane.

## VII. Përfundim: të arriturat dhe sfidat para nesh

Sikurse është paraqitur në këtë raport, viti 2009, viti i parë i ushtrimit të funksioneve gjyqësore ishte një vit sfidues por i çmueshëm për gjyqtarët e EULEX-it. Janë disa të arritura që duhet të theksohen. Përpunimi i lëndëve penale të marra nga UNMIK-u është në vazhdim e sipër. Lëndët e trashëguara nga UNMIK-u tashmë janë përfunduar në nivelin e Gjykatës Supreme e po ashtu edhe Gjykatat e Qarkut kanë bërë një përparim të dukshëm në arritjen e këtij qëllimi. Gjyqtarët e EULEX-it në regjionin e Mitrovicës kanë marrë dhe kanë kryer një numër të lëndëve penale komplekse duke u kontribuar në këtë mënyrë përpjekjeve për kthimin e funksionimit efektiv të GjQ-së në Mitrovicë. Punë e mëtejme është bërë për të përkrahur gjyqtarët e Kosovës në trajtimin e 22,000 lëndëve të pazgjidhura apo 'lëndëve të pezulluara' të cilat përfshijnë ankesat kundër KFOR-it, UNMIK-ut dhe komunave vendore. Deri më tani, veprimet kanë përfshirë *inter alia* kategorizimin e kërkesave dhe zhvillimin e strategjisë së përgjithshme për monitorimin, udhëzimin dhe këshillimin; gjetjen e zgjidhjeve lidhur me vështirësitë e njoftimit dhe të thirrjes së paditësve; kompletimin e listave kontrolluese mujore të monitorimit për secilin regjion të Kosovës; si dhe shqyrtimin e mundësisë për një projekt alternativ të kompensimit. Këto prioritete mbeten në agjendën e gjyqtarëve të EULEX-it edhe për vitin 2010.

Gjyqtarët e EULEX-it gjithashtu po përballen me vështirësi edhe në përmbushjen e mandatit të tyre. Numri i planifikuar i gjyqtarëve të EULEX-it ende nuk është arritur, dhe momentalisht ka gjykata në të cilat ka vetëm nga një gjyqtar penale të EULEX-it (Gjykatat e Qarkut në Pejë, në Prizren, dhe në Gjilan) si dhe vetëm një gjyqtar civil i EULEX-it (GjQ e Pejës). Mungesa e numrit të duhur të gjyqtarëve penalë e vështirëson formimin e kolegjeve si dhe kërkon përfshirjen e gjyqtarëve civilë të EULEX-it gjatë fazës paraprake por edhe si anëtarë të kolegjeve. Po ashtu ka vende të lira pune për gjyqtarët e shkallës së parë në DhPGJS, ku emërimi i gjyqtarëve vendorë është gjithashtu problematik (momentalisht është vetëm një gjyqtar vendor në DhPGJS, ndërsa janë shpallur 7 vende të lira në kolegjet për ankesa dhe kolegjet e zakonshme).

Njëkohësisht ka edhe vështirësi të natyrës administrative posaçërisht ato që ndërlidhen me ndërtesat. Në shumicën e regjioneve nuk ka hapësirë të mjaftueshme në ndërtesat e gjykatave të qarkut dhe si pasojë një pjesë e personelit të gjyqtarëve të EULEX-it janë vendosur në ish bazat e UNMIK-ut apo në objekte të tjera, gjë e cila pengon bashkërendimin brenda ekipit. I njëjti problem ekziston edhe me personelin e DhPGJS-së të cilët janë të vendosur në dy objekte të veçanta.


Megjithëse ka pengesa, si edhe vazhdojnë problemet lidhur me personelin dhe administratën, gjyqtarët e EULEX-it janë të vendosur të vazhdojnë punën e tyre në mënyrë që të sigurojnë se lëndët e krimeve të luftës, të terrorizmit, të krimit të organizuar, të korrupsionit, të krimeve ekonomike/financiare dhe të krimeve të tjera të rënda, si edhe çështjet të cilat ndërlidhen me pronësinë, të gjykohen si duhet.

Në kryerjen e këtyre funksioneve gjyqtarët e EULEX-it do të vazhdojnë të bashkëpunojnë me kolegët e tyre vendorë. Bashkëpunimi efektiv tashmë është vendosur në mes të gjyqtarëve të EULEX-it dhe atyre kosovarë në të gjitha gjykatat e Kosovës.

Në përmbyllje të këtij raporti, mirënjohje e veçantë shkon për z. Rexhep Haxhimusa, ish-Kryetar i Gjykatës Supreme dhe z. Fejzullah Hasani, Kryetar aktual i Gjykatës Supreme, z. Salih Mekaj, Kryetar i Gjykatës së Qarkut në Pejë, z. Ymer Huruglica, ish-Kryetar i Gjykatës së Qarkut në Gjiilan, z. Ymer Hoxha, Kryetar i Gjykatës së Qarkut në Prizren, z. Kapllan Baruti, Kryetar i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë dhe z. Anton Nokaj, Kryetar i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë si dhe për Gjyqtarët në GJS, në GjQ dhe në GJK anembanë Kosovës për bashkëpunimin e tyre të vazhdueshëm në arritjen e qëllimit të përbashkët për forcimin e sistemit gjyqësor në Kosovë.


## VIII. Diagramet që paraqesin të dhënat statistikore në raportin vjetor të Njesisë së Gjyqtarëve të EULEX-it

Fig.1. Kërkesat që i janë drejtuar Kryetares së Asamblesë së Gjyqtarëve për marrjen e lëndëve







**Fig 2. Kërkesat për marrjen e lëndëve nga gjykata**




**Fig 3. Kërkesat e bëra nga parashtruesit për marrjen e lëndëve penale**




**Fig 4. Kërkesat e bëra nga parashtruesit për marrjen e lëndëve civile**




**Fig 5. Lëndët penale sipas gjykatës në fazën e procedurës paraprake**




**Fig 6. Lëndët penale sipas gjykatës në fazën e gjykimit**




**Fig 7. Totali i lëndëve penale në fazën e procedurës paraprake (në të gjitha gjykatat) sipas veprës penale**



**Fig 8. Totali i lëndëve penale në fazën e gjykimit (në të gjitha gjykatat) sipas veprës penale**




**Fig 9. Aktgjykimet gjithsej nga Gjykata**







**Fig 10. Aktgjykimet sipas veprës penale**



**Fig 11. Kërkesat e reja të regjistruara në vitin 2009 sipas llojit të kërkesës**



**Fig 12. DhPGjS vendimet procedurale (pranueshmëria, referimi,etj) / Aktgjykimet (vendimet e formës së prerë mbi meritat) sipas llojit të lëndës**



**Fig 13. Lëndët e DhPGjS-së të mbyllura sipas llojit të lëndëve**

